

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME SABRI NOVOSELLËN

Prishtinë | Data: 26 prill, 2022

Kohëzgjatja: 139 minuta

Të pranishëm:

- Sabri Novosella (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Sabri, nëse mundeni me u prezentu, vitin e lindjes, vendin, diçka për prejardhjen e juj? Familjen?

Sabri Novosella: Unë jam Sabri Maxhuni Novosella, baba Smajl Maxhuni, nana ime Naile Shala. Jam i lindur me 3 maj, 1943. Jam i lindur në Vushtrri, prejardhjen e kemi nga fshati Maxhunaj. Familja jonë me të vërtetë e ka ni histori të bujshme që nga e kaluara, që nga kangët që këndohen për Cen Maxhunin e tjerë, e tjerë. Në vazhdimësi pastaj prindët tonë, gjyshi im, ka qenë mik, shok i ngushtë i Hasan Prishtinës në vitin 1912, në luftën çlirimtare të Kosovës, faktikisht për të mund të them edhe ma vonë. Për vendimet ma të rëndësishme, kohnat ma të rëndësishme të historisë së kombit shqiptar janë, Lidhja e Prizrenit, Kuvendi i Taksimit, Kuvendi i Mukjes e tjerë.

Pra, se çka ishte Kuvendi i Taksimit po e them disa fjalë të profesor të Zekerija Canës, të cilin e kam pasë mik. Thotë, “Po të zbatoheshin idetë e Hasan Prishtinës, po të zbatoheshin vendimet e Kuvendit të Taksimit, të shliroheshin katër vilajetet shqiptare, të shpallej pavarësia e Shqipërisë me Shkupin e çliruar. Vetëm dy orë të ekzistonte ajo pavarësi, tjetër rrjedhë do të kishte historia e kombit shqiptar”. Në atë shpallje të pavarësisë ka qenë edhe gjyshi im, Selim Maxhuni, Selim Cen Maxhuni, i cili kur më tregonte si fëmijë për ngjarjet e asaj kohe m’u doke sikur prallë ashtu.

Kur ma vonë pata rast edhe më ra në dorë libri i Hasan Prishtinës, kujtime të shkurta nga ngjarjet e 1912-ës, të cilin libër e kom botu, e kom ribotu prapë, fotokopjume pa prekë asni pikë, asni prekje në librin për Hasan Prishtina, “Hasan Prishtina dhe tradhëtia e madhe”. Në botimin e parë i kom botu dy mijë ekzemplarë, botimin e dytë i kom botu tre mijë ekzemplarë, botimin e tretë i kom botu pesë mijë ekzemplarë. Faktikisht në dhjetë mijë ekzemplarë është botu ai libër dhe libri i Hasan Prishtinës është ribotu në të edhe sot në bibliotekën time tre-katër libra kanë mbetë, se të gjithë kanë marrë lexuesit.

Pra, baba, gjyshi im nga familja jonë, masanej në Luftën e Dytë Botërore ma kanë vra mixhën, Xhafer Maxhunin, ma kanë vra djalin e mixhës të babës. Na ka vra 27 maxhunë, që janë konë në luftë krah për krah me Shaban Polluzhën, heronj të kombit. Them me mburrje, me krenari, asniherë s’ka ndodhë asni mashkull i familjes tonë me kenë në anën e okupatorëve, në anën e serbëve. Na kanë vra Jahja Maxhunin kryetarin e NDSH-së për rrethin e Vushtrrisë. Kjo ka qenë në pika të shkurta e kaluara.

Pasanej në vitin 1953 kemi kaluar nga Vushtrria në Prishtinë kemi ardhë, jemi vendosë në Prishtinë. Si kemi ardhë këtu kojshi na ka qëllu Adem Demaçi. Ishte ai sa vjet para nesh, krijum ni afërsi me të. Ra Adem Demaçi në burg, dul nga burgu edhe e themeloi organizatën Lëvizja Nacional, Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve - LRBSH. Besoj që prej të parëve më njofoi Ademi, gja që unë meniherë me kënaqësi ma të madhe pranova dhe u organizova. Ishte viti 1963, u organizum. Pas ni kohe edhe pse isha mjaft i ri, isha në moshën 20 vjeçare, u organizova në moshën 20 vjeçare, na burgosën ni vit ma vonë.

Më zgjodhën anëtar të Komitetit të Qarkut të Prishtinës, ku ishim nantë veprimtarë në mesin e tyre isha edhe unë. Tanshi, po thom pak edhe me cinizëm pak edhe me shaka, gjithmonë flitet që kemi vujtë, kemi hjekë prej shkaut¹. Jo, ne s'kemi hjekë, s'kemi vujtë fare, shkau ka hjekë prej nesh, shkau ka hjekë prej nesh. Shkau, çka me na bo, s'ka mujtë me na zhdukë. Me këto durë, se unë kam qenë në atë kohë kam qenë rrobaqepës me profesion, me kërkesë të Ademit edhe shokëve, i kam qepë 94 flamuj kombëtar shqiptarë. Në ni mëngjes kur janë ngritë okupatorat semi-komunist dhe i kanë pa flamujt që i kam qepë me durtë e mia të ngritun në të gjitha antë e Kosovës.

Ni shok i joni, ni veprimtar i joni i cili ka qenë ai në burg, Selmon Berisha ai e ka pasë për detyrë me ngritë flamuj edhe në Fushë Kosovë. Rastësisht kalon kah treni edhe e shef ni tren ka qenë kah ora dy-tre të natës, e sheh ni tren që ka pasë me shku për Beograd. Në ballë të trenit e vë ni flamur kombëtar *fap* {onomope} aty e lidh mirë, e shtrëngon. Kështu që, të nesërmen në mëngjes kur mrrin treni në Beograd, në ballë flamurin kombëtar shqiptar. Unë e them me krenari, me mburrje që e kam kepë me durë të mija. Pra, veprimtaria jonë ka qenë, a din, me marrë që ka qenë gjeni.

Unë shkrimin e parë e kam shkru për Adem Demaçin, ma vonë. Jusuf Gërvalla ma ka botu në “Zërin e Kosovës” se unë isha në Turqi. E kam qujtë Adem Demaçi simbol i rezistencës kombëtare. Adem Demaçi ka qenë simbol i rezistencës kombëtare. Përcaktimet e organizatës tonë me program me status e të cilat janë sot, dokumente janë, askund Adem Demaçi s'ka përmend Stalin, s'ka përmend Enver Hoxhë, s'ka përmend parti, s'ka përmend komunizëm. Osh' ni nen i veçantë i statutit të programit të LRBSH-së ku thotë, “Çdo ndihmë do ta pranojmë kah do të që vjen”. Pra, edhe prej Amerikës edhe prej tona antë e botës. “Nëse është e pakushtëzume”. Pra, është nen i posaçëm në statut.

Në veprimtarinë tonë u zhvillu ni akvitet, po Adem Demaçi ishte shumë i meçëm, ishte... ai faktikisht, faktikisht qëllimet e tina ishin gjeniale. Se kush ishte Adem Demaçi po ju them juve, këtë ma ka vërtetue ni hungarez në burgun e Goliotokut. Pak ni ndërpreme. Me atë hungarezim u shoqnum, punojshim na kishin caktu në të njejtin vend me punu. Me ni rast i thom, ai hungarezi në burg tjetër kishte nejt me Adem Demaçin, se Adem Demaçi nejt 28 vjet nëpër burgje. E njëjfte Ademin. Po i thom ni ditë, “Ju hungarezët i keni puntë mirë”, tha, “Pse i kemi?” Thashë, “Po keni shkolla, keni punë, keni të drejta”.

¹ *Shka* (m.), *shkinë* (f.), shumë *shkijet*, term derogativ që shqiptarët e përdorin për serbët.

Hungarezët në përgjithësi i kanë pasë puntë shumë mirë, si të gjithë banorët e Hungarisë e Vojvodinës. “Jo”, tha, Novosellac më thojke “Ne Novosellac, na i kem puntë shumë keq. Na kena m’u zhdukë, kena m’u shu krejt”, thotë, “ju i keni puntë shumë mirë”. Thashë, “Qysh ndodhë kjo? Pse na mirë? Edhe ju e dini puntë tona qysh janë”, “Jo”, tha. Po ju thom original qysh ma ka thanë e po ju përkthej shqip, “*Mi nemamo Adema Demaçija, vi imate Adema Demaçija*, Ne nuk e kem Adem Demaçin, ju e keni Adem Demaçin. E lufta e Adem Demaçit që është kah e bon me ni mençuri të fortë, p’e përgatitë popullin shqiptarë për çlirimin e Kosovës. Për ni moment të duhur që Kosova e ka lirinë e sigurune”.

Ademi si gjeni që ishte asniherë nuk kanë ditë ekcese as vrasje, vetëm ni zhvillim të ni propagande të përgatitjes së popullit psikikisht, ideologjikisht për momentin e caktum. Në momentin e caktum që gjithmonë t’u e parapa ndihma kahdo që të na vjen. Ndhimën e Amerikës e ka parapa gjithmonë. Kështu që...

Anita Susuri: Zotni Sabri, kisha dashtë pak me u kthy në do pika që i përmendet ma herët se po besoj që prej fëmijërisë të juj ka fillu ky zhvillimi, formësimi...

Sabri Novosella: Ma kanë vra mixhën.

Anita Susuri: Po. Më tregutë edhe për gjyshin e juj që kur keni qenë fmi ju ka tregu...

Sabri Novosella: Po.

Anita Susuri: Ju ka tregu për ato mbledhjet e vitit 19...

Sabri Novosella: Luftat, luftat. Luftat çlirimtare...

Anita Susuri: Çka ju ka treguar ma konkretisht?

Sabri Novosella: Po më ka tregu të gjitha ato që ma vonë i kom lexu në librin e birit ma të madh që e ka lind nana shqiptare, Hasan Prishtina. Ai ka tregu gjana shumë interesante. Në atë kohë... nashta më bon kjo pak dallim edhe prej atyne fëmive tjerë, se e pajke ndoshta interesimin tim. Më ka tregu gjana që unë edhe s’kom besu aq, po kur kam lexu librin e Hasan Prishtinës ato të gjitha kanë qenë ashtu. U shliru vijaleti i Kosovës me 32 mijë kilometra katror, u shliru Shkupi.

Po i citoj fjalët e gjyshit, “Erdhën nga të gjithë Avropa [Evropa] e pytën Hasan Prishtinën, ‘Pse po lufton?’ Hasan Prishtina tha, ‘Po luftojmë me bo Shqipninë’. Intervenoi Isa Boletini, Riza Bekë Gjakova, tha, ‘Jo’, tha, ‘na nuk po luftojmë veç me bo Shqipninë, na nuk e dojmë Sulltan Reshanin e dojmë Sulltan Hamitin’”. Dhe ato i argumenton Hasan Prishtina në librin e tij kur thotë se vetëm me u folë, me u përmend jo independenca, pavarësia po veç m’u përmend autonomia, shpallja e autonomisë në

Shkup u dufke me u vra me Isa Boletinin, Riza Bekë Gjakovën. Pasiqë të dytë ishin agjentë të Serbisë. Ishin në marrëveshje të ngushtë me Serbinë. Atyne ju duhej me bo ni luftë të kotë me shku me nxjerrë Sulltan Hamitin prej burgut të Selanikut.

Këto gjana kanë qenë atëherë për mu të pabesueshme. Ka qenë ndoshta pak edhe, se kur fliste gjyshi ai qante, thosha ndoshta edhe nga ajo dashuria e tepërt që e kishte ndaj Hasan Prishtinës. Kur e lexova librin e Hasan Prishtinës, gja që e kem atë libër te unë tashi osht' e ribotume në pjesën e parë, ishin shumë të vërteta. Pasanena këto të vërteta po na i argumenton edhe historianja Elena Kocaqi, e cila i ka dy doktoratura. Ni doktoraturë e ka mbrojtë në Tiranë, njo në Vienë, dhe flet që nga Shkupi bashkë me ushtrinë serbe Isa Botelini shkon deri në Vlorë, deri në Durrës. Ku vriten, e priten, e përgjakën territoret shqiptare, ai ishte bashkë me ta.

Po tani ta kemi parasysh, jo që kom diçka kundër, se familja jonë ka qenë me Hasan Prishtinën gjithmonë, ka qenë kundër Isa Botelinit. Po ta kemi të kuartë, unë s'kom asgja kundër Boletinëve, se ky Isa Boletini osht' dëshmu që ka qenë agjent i kraljit. Por, e ka pasë, ka pasë shumë femi, më doket tetë djem ka pasë. Katër djem të Isa Boletinit janë heronj të kombit, që shumë pak përmenden. Njo e kanë vra në Shkodër, dy i kanë mbytë në burgje të Enver Hoxhës edhe një, domethonë i katërti, e kanë mbytë në Burgun e Prizrenit. Pasi që komunistët, Fadil Hoxha e kta kur e murrën. Pra, Boletinët janë familje e heronjëve, por kanë dhanë edhe tradhëtarë, kanë dhanë edhe heronjë. T'mos ketë ndonjë keqkuptim që kam diçka kundër Boletinëve. Apsolutisht.

Anita Susuri: Ju thatë që si fmi keni ardhë, domethonë, ndoshta në moshën dhjetë vjeçare keni qenë kur keni ardhë...

Sabri Novosella: Fiks dhjetë vjeçare.

Anita Susuri: Qysh e keni pa ju krejt atë dinamikën edhe të qytetit t'u u formu po edhe për jetën sociale të njerëzve, politike? Qysh e keni pa ju atë? Po mendoj ju si fmi ndoshta nuk e keni pasë shumë të qartë, apo ndoshta... si e keni përjetu?

Sabri Novosella: Më besoni, jam rritë që nga fëmijëria, jam rritë që nga fëmënia me këtë frymë. Pse? E vranë sërëbët, ma vranë mixhën. Pra, '45-ën s'isha shumë i vogël. Ma vranë ni dajë, Zymer Shalën. Familja jonë ishte me të vërtetë që e kishte... në familjen tonë në përgjithësi bisedat janë bo qysh na vranë, qysh na mytën, qysh qëndroi ky, qysh s'u gjetë kufoma e tij, s'u gjetë këtu kufoma e tij. Ne erdhëm në Prishtinë në vitin 1953, kur erdhëm në vitin 1953 në Prishtinë ishte Prishtina, në përgjithësi Kosova, shpërnguljet e mëdha që boheshin për Turqi...

Anita Susuri: Kohën e Rankoviqit.

Sabri Novosella: Po, kohën e Rankoviqit. Kështu që, në ato ditë kom shumë, shumë raste kam që ka përjetu tepër vështirë. Ne, baba e ka pasë ble do tokë përmi vorret shqiptare atje edhe përmi fabrika, ka qenë fabrika e tjegullave, e tullave i thojshin “Cigllanë”. Ni mëngjes t’u kalu asajde, i pasha njerëz janë tubue në ni strehë të fabrikës, u afrova. Kur u afrova e pashë aty kishte qenë, e kishte varë vetën. Jo me konop, me tel. Shumë po më vjen keq që më ka ikë emri për momentin, se me të vërtetë edhe mosha ime e ka bo që unë të ruhna. Po më duket edhe pas vaksinës {bën shenjë tek krahu} po harroj. E harrova emrin si e pat’. Gashi mbiemrin e ka pasë. I kishin kërku armë, e kishin torturu, i kishin thanë me na pru armë. Nga pamundësia me çu armë nuk ka dashtë me ra në dorë tyne m’u torturue. S’kish pasë pare me ble konop, me tel e kishte vjerrë vetën. Pra, rritesh me ni kohë të tmerrshme. Ku i pajshim njerëzit kah e varin vetën.

Tash dua t’ju them edhe ni rast, se osht’ shumë interesant. Ni fqinj i joni ka qenë burrë e grua edhe shpërngulja, shpërngulja ishte e tmerrshme. Vaji që u bojke, qysh e përjetojshin njerëzit. Ata e kishin ni qen. Unë kam pasë, i kam dashtë qentë. Tani edhe fmitë e mi qashtu, djemt, e nipat, e stërnipat. U thashë atyne që... ata u pregatitshin me shku në Turqi. U thashë atyne, “Kur shkoni në Turqi me ma dhanë qenin mue”, ata më thanë, “Kena me ta dhanë se e di që e man mirë”, e kështu. Erdhi dita m’u shpërngulë. Shkova me ta me ma dhanë qenin. Qeni s’ke që e prekë, nuk dahet prej tyne. Ata ecën e shkunë në kamë deri te Stacioni i Trenit. Qeni pas tyne. Ata hypën në tren, u nis treni për Turqi, qeni hupi. E ma s’e pashë për momentin.

Kur u ktheva te shpija ishte fqinji i jonë e pashë para derës ishte ulë qeni edhe rrinte. U munova me prekë, me më hongër, ikte. S’mujta me kapë. Merre me mend tash, puna e kafshës. Disa herë i çova ushqim nuk e hongër ushqimin. Mas katër-pesë dite ngordhi, ushqimin para e pat’. Nuk pranoi, vetëm të zotë e vet i pritke, të zotë nuk i erdhën se shkun, i hupën. Ashtuqë, vetëm vaji, ato përjetime që të shpërnguljes kanë qenë tmerr, tmerr kanë qenë. Kështu që, kem pasë ni jetë me të vërtetë shumë të bujshme.

Anita Susuri: Ju thatë që ka qenë fqinj i juji Adem Demaçi edhe qysh ka ndiku, si me thanë, prezenca e tij? Ai ka qenë ma i madh se ju.

Sabri Novosella: Po, ai ka qenë ‘35-sh unë i ‘43, domethonë tetë vjet ka qenë para meje.

Anita Susuri: Po. Qysh ka ndiku ai? A ka qenë edhe kjo domethonë arsyeja që ju me... sigurisht po.

Sabri Novosella: Valla s’di çka them, e them... bile edhe vet Ademi e thotë, bile vet Adem Demaçi e thotë...

Anita Susuri: Domethonë ju deshtët me lexu këtë... këtë shpesh e ka përmend në rrethin e juv Adem Demaçi...

Sabri Novosella: Qe, shpesh herë e ka përmend nëpër neja edhe tjera po e ka përmend edhe këtë.

Anita Susuri: “Gjatë gjykimit në vitin 1964, prokurori më akuzoi rëndë se i ka marrë në qafë kta të ri. Sabriu u ngrit dhe kërkoi fjalën. Gjykatësi duke shpresuar se do ta vërtetonte akuzën, ia dha fjalën dhe i tha që të dal në foltore. Sabriu tha, ‘Demaçi nuk mban përgjegjësi për antarësimin tim në lëvizje. Ka qenë vullneti im, çdo përgjegjësi ka qenë e imja’”. Po (qeshë), që ju pyta unë.

Sabri Novosella: Po.

Anita Susuri: Domethonë...

Sabri Novosella: Qe, për shembull, ka qenë edhe ni rast tjetër. Bile edhe këtë shumë herë e ka përmend Ademi. Kur na çunë... se në burg Adem Demaçi u dënu 15 vjet, mu më dënunë nantë vjet e kështu me radhë. Na çunë në burgun e Nishit nga nantë vetë përneherë në marincë të policisë. Kur u afrumë në dyert e burgut, atje ni polic e çeli derën e burgut me hye makina. Po ajo me hekra, ajo kërsiti dera *grrum, grrum, grrum* {onomotope}.

Ni milic që ishte me ne, që na përcillte tash u tallë me Adem Demaçin. Tha, serbisht po ua them, “*Otvorite sarajska vrata*” [srb.: Hapni dyert e sarajit/pallatit]. Unë ju përgjegja meniherë, “*Otvorite sarajska vrata da primite Adema kosovskog junaka*”. “Çelni dyrtë e parajsës”, ai tha me cinizëm. Thashë, “Çeli dyrtë e parajsës me pranë Ademin, trimin e Kosovës”. Ademi ma kthej, tha, “*I Sabriju bajraktara*” “Edhe Sabri flamurtarin”, që e kisha qepë. Kështu ishin momentet në situata tepër të rana, të shtira. Po edhe aty e kishim atë guxim tonë që gjithmonë armikut me ju përgjegjë.

Anita Susuri: Po po më intereson edhe ajo lagja ku keni jetu si fmi, çfarë lagje ka qenë? Qysh ka qenë infrastruktura me thanë? Shtëpitë?

Sabri Novosella: Po në përgjithësi...

Anita Susuri: Fqinjësia.

Sabri Novosella: Në përgjithësi shtëpitë kanë qenë shtëpi të marume mund të them në kohën e osmanlisë. Shtëpi të vjetra kanë qenë. Në aso shpi kem jetue. Po tash me Adem Demaçin kem qenë derë më derë edhe jemi kontakt masanej edhe nana ime me nanën e Adem Demaçit kanë pasë atë afërsinë e përhershme. Por, faktikisht që nga koha që kam shku jemi vendosë në atë lagje quhej Lagja Çekli, se ka qenë ni qeshme e kahershme. Rruga Rijeka, aty kemi qenë me Ademin vazhdimisht derisa u organizum.

Pasi u organizum atëherë veç kontakte kishim të caktume, deri në burgosje. Pas burgosjes jemi liru. Pasi ka dalë prej burgut Adem Demaçi, kemi qenë gjithmonë bashkë. Edhe mas burgut të fundit... bile

ni pjesë të mirë e ka kalu edhe në Banjë të mia, masi i kom maru. Se në Banjë e kanë pasë gjithmonë rregull edhe e kanë, prindët e dëshmorëve mirren pa pagesë. Ish të burgosurit politikë mirren pa pagesë, invalidët e luftës mirren pa pagesë, e tjera, e tjera. Kështu që... kurse Ademi e ka pasë dhomën e posaçme, ashtu si Nura edhe profesor Skender Riza edhe ai e ka pasë dhomën e posaçme. Ndjesë se ka dekë.

Janë mundu me tregu ni kujdes ndaj ktyne njerëzve. Kurse, kurse ramja e Ademit në burg, në burgun e parë. Se në burgun e parë u ra në '58-ën, i majti tri vjet. E pat' ni qëllim heroik. Qëndrimii Adem Demaçit para burgut ishte madhështor. Faktikisht ato fjaltë që i tha Adem Demaçi para burgut mrena natës u përhapën, u përhapën në krejt Kosovën. Ishte koha e shpërnguljes. Ai e majti ni fjalim, fjala e tij ke e ashpër kundër shpërnguljes. "Ky osht' vendi jonë, ktu janë vorret tona, ktu na duhet me hi në dhé, nuk bon m'u largu kurrsesi". Më besoni, të nesërmen kanë fillu m'u përhapë fjaltë e Adem Demaçit edhe kanë ndiku shumë në pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve nga Kosova për në Turqi.

Anita Susuri: Po më intereson edhe në atë kohë qysh ka qenë fryma? A u vrejt qajo fryma e rezistencës apo ma shumë njerëzit janë dorëzë? Se ka pasë shumë që kanë shku.

Sabri Novosella: Shif çka them. Si gjithmonë ka qenë ni numër i caktum të cilët janë marrë me aktivitete konkrete. Pjesa dërmuese e popullit kanë qenë të paknaqun. Pak familje ka që nuk janë goditë qysh nga okupimi, që nga okupimi i Kosovës, riokupimi i Kosovës nga serbo-sllavët dhe deri në vazhdimësi. Kështu që edhe ai për ne ishte ni tmerr i madh tash. Pasi u riokupu Kosova u bo ni riokupim me të vërtetë i tmerrshëm. Pasiqë erdhën nga Shqipëria... se ne Shqipërinë na kanë shpallë, e kanë thanë me argumente se kuvendi i Mukjes, është një prej kuvendeve ma të rëndësishme në historinë e kombit shqiptarë. Në të cilin kuvend morën pjesë përfaqësues e të gjitha rrymave politike edhe u murr vendim që me luftue kundër Nazi-fashizmit. Konform forcave, njerëzve, mundësive ushtarake, armatimit në aleancë të ngushtë me aleatët anglo-amerikan.

Kurse Milladin Popoviqi dhe Dushan Mugosha në vitin 1941 e themelojnë një bandë gjakatare, ni bandë kriminelësh me emrin Partia Komuniste e Shqipërisë, e cila kishte për detyrë, kishte për detyre faktikisht m'i vra shqiptartë. Merre me mend, u vranë 28 mijë dëshmorë me emra e mbiemra, u varrosën tu u vra mes veti. Bile, kallxojnë ni rast në ni tubim në Tetovë foli Paskal Milo i lavdoi brikadat shqiptare qysh kanë luftu në Kosovë për çlirimin e Kosovës. Edhe u ngrit Sabri Godo, e kom të inxhizume, se kishin ardhë, na kishin thirrë në atë tubim në Tetovë. Ni tubim ke, na kishin thirrë disa nga Kosova, disa nga Shqipëria. Nga Shqipëria ishte edhe Paskal Milo dhe Sabri Godo. Bile Sabri Godo i revoltum me Paskal Milton që tha e kena shliru, kena kontribu në shlirimin e Kosovës dhe dul e tha ni gja që osht' shumë interesant dhe osht' e çlirune.

Tha, "Ishte në moshën 17-18 vjeçare, pra isha fmi. Na organizunë me shku në luftë kundër gjermanit në vitin 1945, kur tërhiqej gjermani. Na çunë në ato brigadat në Mal të Zi. Pas dy-tri ditësh na erdh urdhëri, duhet me shku në Kosovë. Në Kosovë të luftojmë Nazi-fashistët, gjermanin, me shliru

Kosovën. U gzumë të gjithë. Po shkojmë në Kosovë te vllazërit tonë kosovarë, t'i ndihmojmë, kontribojmë në çlirimin e Kosovës. Na shkum në Kosovë, filloi lufta. Ni gjerman nuk e kemi pa. Me sy të mi", para 400-500 vetëve e thonte, "me sy të mi i kom pa kah 15-20 kufoma të shqiptarëve duke i futë me ni pus", na i thojmë bunar ata i thojnë pus. "Bojnin masakër kundër shqiptarëve ku merrshin pjesë edhe brigadat e Milladin Popoviqit", për shembull Mugoshës dhe të Enver Hoxhës.

Ishin ato situata me të vërtetë tepër të rana, tepër të vështira. Kështu që, kjo shkoi deri në '48-ën. Në '48-ën pastaj ndodhi kjo rezoluta e infobyrosë, Tito u nda dhe u lidh me botën e perëndimit, me Amerikën. Disa shqiptarë prapë, bile shkun nëpër burgje. Gja që ata lanë pasoja tepër tepër të rana. Kështu që, ku e patëm fjalën për Adem Demaçin. Adem Demaçi edhe nga burgu rrezatonte rreze lirie, dritë lirie. Pse? Qëndrimi i tina ishte jashtëzakonisht i mirë, i drejtë. Pa lejue m'u futë në vetëvrasje. Ashtu siç ndodhi pas kushtetutës të '74-ës, gjë që do të folim.

Anita Susuri: Po. Deshta me ju pytë në Prishtinë cilën shkollë keni vazhdu, shkollën fillore shkollimin e juj?

Sabri Novosella: Shkolla fillore, "Vuk Karaxhiq", tash quhet shkolla, "Elena Gjika". Aty e kom kry tetëvjeçaren. Pasanej...

Anita Susuri: Qysh kanë qenë qato vite të shkollimit?

Sabri Novosella: Po ato kanë qenë shkollë në gjuhën shqipe, po shkollë e shkaut. Merre me mend në klasën e pestë në serbisht e kisha pasë dysh më doket ka qenë, ka qenë. Edhe në provim shkova, pse ni notë e pata të dobët në serbisht më ngelën në klasë, u dashtë me përsërit klasën. Ishte ni gjendje tepër e randë, tepër e vështirë. Pasanena na ishim në burg, na burgosën edhe msusët. Na burgosën Rashit Krasniqin, na burgosën... katër-pesë msusë na burgosën.

Anita Susuri: Ata kanë qenë ndonjë organizatë apo?

Sabri Novosella: Po, po, në organizatë kanë qenë. Ka qenë organizata NDSH-eiste, se organizatat në Kosovë që janë themelue deri mas vitit 1900, masi u fitu kushtetuta e '74-tes organizatat kanë qenë kombëtare, kanë qenë natyraliste. Tash pasi u themelue, që ishte për shembull, burgosjen e '64-ës, tani erdhën burgosja e '68-ën, demonstratat e '68-ës të cilat ishin komplet kombëtare, atëdhetare. Kështu që edhe vet Jugosllavia i kishte dy linja. E kishte linjën serbo-sllave ortodokse edhe e kishte linjën kroato-slllovene katolike pro evro-amerikane.

Në kreun e Jugosllavisë vazhdimisht ishte kjo ndeshje. Bile p'e citoj ni akademik serb të cilin e kam ndëgjue në Suedi, se unë jam në Suedi prej '64-ës, prej '84-ës. Pata rast me ndëgjue në emision të Beogradit. Ai akademiku plak, kishte qenë në spital kishte dalë nga spitali, që për mu më ka bo përshtypje jashtëzakonisht shumë. Ishin shku gazetartë me ia bo ni vizitë edhe mes tjerash e pytën,

thanë, “Kur u nda Jugosllavia?” Adademiku u përgjigj, “Jugosllavia u nda në mbledhjen e AVNOJ-it². Tha, “Kur murr fund ndamja e Jugosllavisë?” Tha, “Ndamja e Jugosllavisë murr fund me kushtetutën e vitit 1974”.

Kështu që, tash kush organizoi mbledhjen e AVNOJ-it? Tita, kroato-slllovenët. Kush e pruni kushtetutën e 1974? Prapë, u rrxu Rankoviqi, u bonë ni varg veprimesh. Se aty ndesheshin dy rryma, rryma serbo-sllavo-ortodokse dhe rryma kroato-katolike pro-europo-amerikane. Tani, kushtetuta e ‘74-tes ishte ni fitore jashtëzakonisht e madhe kundër lindjes sllavo-greke-ortodokse, sllavo-serbo-ruso ortodokse. Ajo fitore e popullit shqiptar, i solli shumë të mira. I solli shumë të mira. Pse? U hapën shkolla, u hapën fakultete, u punsunë njerëzit.

Merre me mend erdh ligji, katër vetë që punësohen me konë tre shqiptarë, me konë ni serb. Kjo fitore e madhe. Pra, gja që pat’ kërkesa edhe m’u konë Kosova Republikë, por nuk e lejunë serbët. Po edhe pse nuk e lejunë m’u konë republikë, ajo faktikisht u bo krahinë autonome, pjesë e Republikës së Serbisë edhe pjesë konstituive e Federatës Jugosllave. Tani këtu erdhën disa situata të tmerrshme. Pse? Njanën anë punohej me të madhe me fitu çka të munësh me fitu, me përfitu çka të munësh me përfitu. Dhe çdo gja shkonte, përkundër burgosjes, përkundër... gja që na masanej edhe të burgosun nuk jemi. Se ato burgosjet që i bonin serbët i bonin me qëllim thjeshtë me trazu Kosovën, me trazu Kosovën.

Kështu që, ndërkohë ne e kishim të organizume tani në organizatë [Metush Krasniqin](#), Shefqet Jasharin, Jusuf Gërvallën e tjerë, që në programin tonë, në statutin tonë e kishim, “Asni veprim, asni ekces mos me bo deri...” se ishim të bindur Kosova pa luftë nuk çlirohet. Ishim të bindur që ajo luftë ka me përfundu, ajo luftë ka fillu me vdekjen e Titos. Të gjithë... ngase e dishim këtë punë, ashtu si ndodhi. Me vdekjen e Titos ka me vdekë Jugosllavia. E kemi pasë edhe në program edhe në statut, “Pa vdekë Tita armtë s’i marrim. Armtë e para s’kanë me qenë tontë, pushka parë s’ka me qenë e jona”. Me bindje të thellë që kroatët kanë me fillu edhe ashtu ndodhi.

Po tani çka ndodhi? Këto arritje që i pat’ Kosova me të madhe u hapën shkollat, u hapën fakultetet, u hoqën vizat. Tash ishte ni dëshirë e madhe e kosovarëve, po edhe ni pjesë e të udhëheqësisë, se ni pjesë e udhëheqësisë e kosovarëve ishte me kroato-slllovenë, ishte kombëtare. Ni pjesë në pakicë ishte me serbë, malazezë, ortodoksë. Për shembull, m’i përmend me emra, Ali Shukria e Sinan Hasani e këta tjerë. Tani, ishte dëshira e shqiptarëve që të kemi marrëdhanie të mira me Shqipërinë. Regjimi i Titos nuk pengojke. Fillunë m’u thirrë profesorë nga Tirana. Vishin me vështirësi tepër të mëdha.

Por, ndërkohë, kjo gjendje e Kosovës, kjo kërkesë e Kosovës që m’i lidhë marrëdhانيت me Shqipërinë... saqë u dha në vitin, u dha ni... në Televizionin e Prishtinës në vitin 1980. E dha ni informatë, “Vitin e ardhshëm kosovarët do të bëjnë pushimet në bregdetin e Shqipërisë, në Durrës.

² Këshilli Antifashist i Çlirimit Popullor të Jugosllavisë (AVNOJ: *Antifašističko veće narodnog oslobođenja Jugoslavije*), ishte një organizatë politike e Komiteteve Popullore Çlirimtare që u krijuan më 26 nëntor 1942 për të administruar territoret nën kontrollin e tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Studentët e Kosovës do të studiojnë në Universitetin e Tiranës. Studentët e Shqipërisë do të studiojnë në Universitetin e Prishtinës. Profesorët nga Shqipëria”, veç vishin aty ktu, “do të vijnë në Kosovë. Profesorët nga Kosova do të shkojnë në Shqipëri”.

Kjo Enver Hoxhën dhe bandën kriminale të tij, bandën gjakatare të tij e tmerroi. Tani, atyne u dushke me ndërmarrë diçka. Çka me ndërmarrë? Me themelue ni organizatë. Në fakt kjo me ndikimin e tyre u formu Organizata Marksiste-Leniniste në krye me [Hydajet Hysenin](#), Kadri Zekën, Jakup Krasniqin edhe tjetër. E tash, vet libri i Kadri Zekës osht’ programi ma i mirë që nga fillimi deri në mbarim. Stalini, Enver Hoxha. Shoku Stalin, shoku Enver Hoxha. E tani çka ndodhi? Atyne ju duhej me goditë Kosovën.

Në vitin 1979 me 20 dhator u rrezikova të burgosem. U burgos... u rreziku m’u burgos Jusuf Gërvalla, iku. U burgos Shefqet Jashari, u burgos Hysen Gërvalla, vllau i Jusuf Gërvallës e disa tjerë. Atëherë me vështirësi tepër të mëdha, me ndihmën e... ma s’pari motra që paska qenë këtu, burri i motrës më çoi në Podujevë. Tri netë më la te vllau i vet, mas tri nete erdh ni shok i vllaut edhe ai aktivist, Fuad Hajdini. Më murr me kerr edhe me më murr se u dufke me më largu prej atyhit se isha i rrezikum. Bile më tha, “Sabri”, tha, “unë jom ardhë me të marrë me kerr”, motra met aty. Tha, “Unë ka me bo çka të thu ti. Nëse thu me kalu kufinin, ia msyjmë kah të thu ti. Nëse thu m’i kap armët e me qëndru, po qëndrojmë”. Domethonë, si ni shok mjaft i mirë.

Thashë, “Unë du me shku në Gjakovë”. Se atje e kisha, ishte anëtar i Komitetit Qëndror, te ni... me Metush Krasniqin, Jusuf Gërvallën, Shefqet Jasharin e themelum organizatën pas shllirimit tonë nga burgu. E themelum Organizatën Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare. Kështu që, unë shkova në Gjakovë me Fuad Hajdinin. Aty te Marku, te Mark Mërturi shkum. Bile ju çova edhe fotografinë e Mark Mërturit e keni aty. Me një familje me të cilën kom marrëdhanie të përhershme tash e... edhe nga Gjakova, ai Marku meniherë e thirri ni shok të vetin, ni aktivist me kerr edhe tha, “Nuk bon me kalu kufinin, me tentu me kalu kufinin kah Gjakova se po sillen policia shumë, po duhet me shku në Mal të Zi”.

Pjesa e Dytë

Sabri Novosella: Tash çka ndodhi, prej atyhit shkum në Mal të Zi. Ishte, po quhej fshati Kurrec. Deri aty, aty Mark Mërturi. Aty kjo Tereza Mërturi ishte e këtij fshati. Aty kishte nanën e vllaznitë. Atëherë, Mark Mërturi me ni vlla të Tereza Mërturit më ndihmunë me kalu kufinin. Me kalu kufinin edhe dola në Shqipëri. Masi dola në Shqipëri atëherë unë... se para se me shku në Shqipni, ne e kishim kriju ni lidhje. Mark Mërturi i kish të partë e vet prej Mërturi, prej fshati Mërtur. Për çdo vjet shkonte atje në vizitë. Ambasada e Shqipnisë në Beograd ia jepke vizën, po.

Kështu që, atëherë ne me Metush Krasniqin, me Shefqet Jasharin edhe faktikisht e krijum nëpërmes lidhjeve e krijum ni lidhje me Ajet Haxhinë, Sali Shatrin edhe Ali Buletinin. Kur e kalova kufinin në atë

anë unë kërkova të takohem me Ajet Haxhinë, Sali Shatrin edhe Ali Buletinin. Bile, ai oficeri i Sigurimit [Shtetëror] që më mori në pyetje, posa e kisha kalu kufinin më tha, po bisedojmë, këto që i thashë para jush, “Familja jonë ka qenë kështu, serbët na kanë vra, ma kanë vra mixhën, ma kanë vra kta, na kanë vra shtatë maxhunë, serbët, serbët”.

M’u drejtu në mënyrë kërcënuese, “Mos shaj serbin, serbët i kem vllazër. Me serbin luftuam gjermanin, armik e kemi Titon që tradhtoi shokun Stalin, Marksizmin-Leninizmin. U shndërrua në shërbëtor të imperializmit amerikan dhe të reacionit europian”. Më besoni, në atë moment, po ia them sinqerisht qe edhe para kamerave. Mu Tita diçka më dul krejt tjetër. Më dul tjetër. *Tap* {onomatope} u ktheva. Po të vinte kralji [Srb.: Mbreti], po të vinte Drazha Mihajloviqi shqiptarë nuk do të metke në Jugosllavinë e kraljevinës [Srb.: Mbretërisë]. Po fati jonë në fatkeqësi që s’mujtëm me kriju shtetin shqiptar. Fati jonë që në pushtet erdhën kroatët, sllovenët dhe u shpëtuam sa u shpëtuam.

Atëherë, ai mu tepër më dëshproi, tepër më dëshproi. Por, ishte ni dëshprim në hapin e parë, u çudita. Pasi shkova, pas... tani prej atyhit më çunë në shtëpinë e Laçit. Bile po ju çoj edhe ktu, në shtëpinë e Laçit ose pak ma vonë. Këtu më majtën dy muj ditë, më pritën shumë mirë, jashtëzakonisht mirë më pritën se ata veç më njëfishin. Faktikisht Ajet Haxhija, Sali Shatri disa vite na kish majt, ishim në kontakt. Se letrat i shkruajshim me Metush Krasniqin, me Jusuf Gërvallën. Çojshim, komunikojshim. Unë letrat i marr Mark Mërturit, se, ia... se si rrobaqepës që isha i rregullojsha ia shtisha këtu mas {bën me shenjë tek supet}. Letrat ua çojshim atyne edhe me ta ishim, faktikisht bashkëpunojshim.

Atëherë ajo thanja që e përsërita pare, që e thashë parzit se në vitin e ardhshëm kosovarët do t’i bëjnë pushimet në detin Adriatik, në Durrës, shkollimi e këto tjerat që i thashë... tani Enver Hoxha, qeveria, Partia e Punës e Shqipërisë, partia e dhunës e Shqipërisë, ata u çmendën fare. Ata i hynën me bo çmos Kosovës me ia futë flakën, me ia futë tymin. Knena kishe në veprim Organizatën Marksiste-Leniniste, në krye me kryetarin e Organizatës Marksiste-Leniniste, Hydajet Hysenim i cili sot osht’ kryetar i asaj organizatës edhe janë kah veprojnë, këtu e kanë qendër. Kështu që, mas dy muj ditë unë kërkova që të qëndrojë në Shqipëri edhe grupin e kem ta formojmë degën në Shqipëri.

Ata më thanë gjoja ktu nuk osht’ e mundur. Thashë, “Po atëherë me më mundësu me dalë jashtë”. Me dalë ose në Europë ose me dalë në Turqi. Tani ndërkohë Jusuf Gërvalla kish dalë në Turqi, Kadri Zeka ishte në Zvicërr. Atyne ju duhej një njeri në Turqi. Pse? Me bo ata që ndodhi në vitin 1981. Kështu që, u zhvillunë situatat, Kosova e kishte marrë ni hov të zhvillimit, të përparimit. Pse? Kroato-sllovenët e kishin pushtetin në dorë. Serbëve iu duhej me kallë Kosovën. Aq sa ju duhej serbëve, ju duhej ma shumë edhe Partisë së Punës së Shqipërisë. Pse? Me ndërpre marrëdhانيت, me ndërpre shkumjet-ardhjet.

Po unë kur e pashë realitetin në Shqipëri, se Shqipëria ishte bo ni, ni, ni vorr. Shqipëria ma keq e kom gjetë Shqipërinë kur kom kalu jom hy në atë anë, populli si jetonte, se kushtet që i kena pasë ktu në burgun e Goli Otokut, se në burgun e Goli Otokut ushqimin e kem pasë ma të mirë, veshëmbathjen e

kem pasë ma të mirë, punën e kem pasë ma... aty [në Shqipëri] ishte ni tmerr. Atëherë çka ndodhi? Erdh viti 1981. Në vitin 1981, te unë ku isha në Turqi e prunë Profesor Doktor Bujar Hoxhën me bashkëpunu me mue. Në Vienë e çunë Engjëll Kolonecin me bashkëpunu me Jusuf Gërvallën, me Kadri Zekën. Çdo gja ishte e përgatitne me kallë Kosovën. Atëherë lëvizja, kjo, Organizata Marksiste-Leniniste e bonte punën e vet. Se kta ishin komplet të lidhun me Sigurimin e Shqipërisë, me [Fatos] Klosin³ e kta, që ka edhe sot. Sot janë. Sot e asaj dite u qujtë Klosi majti fjalim kundër Amerikës, kundër Rusisë, të më falni, faktikisht e mbrojti Rusinë me luftën në Ukrainë.

Erdh viti 1981. Në vitin 1981, shpërthynë demonstratat. Aty demonstrata u organizunë. Bile t'ua thom edhe si rast, kur vdiq [Murteza] Xaja Nura ishim në Gjakovë. Aty u majtë tubim komemorativ për vdekjen e... edhe pasi dolëm... me Ali Lajçin kurrë s'isha taku po e njëfsha mes... ai më pa. Tha, "Sabri", tha, "e kom ni bisedë me ty", thashë, "Ali Lajçi edhe unë e kom me ty ni bisedë. Gjithsesi kur të dush, por vetëm ni pyetje e kam asgjë tjetër tani bisedojmë", thashë, "natën që i organizutë në konvikte të studentëve demonstratat e '68-ës prej mramjes deri në mëngjes. Të gjithë që ketë në atë tubim u burgosët, një nuk u burgos. Si e kishte emrin ai?" "Po ato kanë qenë lëvizjet gjithë populllore", "Ju lutem, çka kanë qenë e di unë, po më intereson ai që nuk u burgos". E ai që nuk u burgos ka qenë spiun i Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Serbisë. Jo Jugosllavisë, jo i Kosovës, por i Serbisë.

Ai nga mrena, kohë mas kohe, dilke përjashta i raportoje Abdullah Prapashticës. Abdullah Prapashtica ishte UDB-ash i Serbisë. Nejse, kishte kry shkollat në Vojvodinë atje, tjera, e tjera. Tani, çka ndodhi? U organizunë demonstratat, u kall, u përvlu Kosova, i hyni tymi në tona antë. Enver Hoxha e kryjti punën e vet nëpërmes... se në ballë të demonstratave Hydajet Hyseni. E kemi në maje të ni lisi ka majtë fjalim. Tash kjo komplet Organizata Marksiste-Leniniste u vu në veprim. Pse çka i duhej Enver Hoxhës. Kurse, meniherë mas demonstratave ne jemi dalë me komunikatë. Unë, organizata jonë, Metushi [Krasniqi], Shefqet Jashari, Abdullah, ky, Jusuf Gërvalla. Bile Jusufi e shkrujti komunikatën. Demonstratat e vitit 1981, Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare nuk i ka organizue. Ata që janë sakrifikue, janë vra, janë burgosë, ata kanë qenë njerëz të pavetëdijshëm çka po ndodhë. Por ata janë me të vërtetë njerëz që duhet me na u dhimtë të gjithve, me na ardh keq për ta, se ata ranë në kurth.

Tani po e citoj, unë këtë e kom thanë nëpër librat e mija, e kom argumentu nëpër librat e mija. Këto e thotë edhe [Azem Vllasi](#), siç e thotë në librin e tina ku folë për demonstratat e '81-tës. A nxjerrë fakte argumente që ato i kisha unë. Thotë, "Ashtu siç thotë veprimtari i mirënjohur Sabri Novosella, demonstratat e '81-shit i ka organizue Serbia, jo federata as Kosova, Serbia i ka organizu". Tani çka ndodhi? Mas atyne demonstratave Kushtetuta e '74-tes mori fund. Me qindra mija, me 300-400 mijë shqiptarë, rini dul rrugëve të botës, u mshelë n shkollat, u mshelën fakultetet, u mshel puna, u bo nomi. Pra, prej '81-tës deri '99-ën, deri 1999 që erdh ushtria e NATO-s, e Amerikës na shliroi nga pushtuesit serbo-sllav e Millosheviqit...

³ Ish shef i Shërbimeve sekrete të Shqipërisë.

Anita Susuri: Zoti Sabri, ishit t'u tregu për demonstratën prej vitit '81. Po po du m'u kthy edhe pak ma herët...

Sabri Novosella: Po.

Anita Susuri: Me bisedu. Ju më tregutë për, për shkollimin fillor që është dashtë me ndërpre, faktikisht...

Sabri Novosella: Na përjashtunë.

Anita Susuri: Po, qysh ka qenë, qysh ka ndodhë krejt kjo?

Sabri Novosella: Kjo ndodhi, se faktikisht në familjen tonë ishte ajo fryma kombëtare, fryma... te na s'u përdorë kurrë fjala serb. Shkau, shkau na e boni, shkau na pushkatoi, shkau na i murr mashkujt, shkau na boni të gjitha. E tash, na veç si fëmijë ishim përgatitë shpirtnisht edhe nga e kalumja jonë edhe nga ato kangtë që knoheshin për familjen tonë. Kështu që, na faktikisht shpirtnisht ishim të përgatitun për aktivitet. Edhe siç e thashë ma parë, p'e përsëris, kontakt me Adem Demaçin, organizimi me Adem Demaçin. Organizon Adem Demaçi, më propozon për... edhe pa asni imponim unë e pranoj me knaqësinë ma të madhe. Isha i martum atëherë, e kisha djalin i lindur tre mujsh kur jom burgosë. Jo, domethonë, kur jom organizue kom qenë i martum, po ma vonë ka lind djali, para se me ra në burg. Familja jonë kështu ka fillue, puna jonë ka fillu. Masanej ajo propaganda mos m'u largu ka qenë shumë, shumë aktuale kudo ku jem, kah shkojmë, me pengu mos m'u largu nga Kosova. Se ajo që bohej, largimi, shpërngulja që bohej për Turqi...

Anita Susuri: Ju thatë që keni reagu për përjashtimin e mësuesve që i përmendet ma herët në fillim edhe ni msuse ju ka dërgu te drejtori edhe pastaj...

Sabri Novosella: Pastaj kishin marrë vendim aty edhe më kanë përjashtu prej shkollës.

Anita Susuri: Pastaj jeni organizu edhe cilat kanë qenë aktivitetet e para?

Sabri Novosella: Aktivitetet e para kanë qenë, aktivitetet e para kanë qenë shkrimi i parullave. Po tani unë si rrobaqepës që isha kepja e flamujve. Kjo për neve ishte shumë e rëndësishme. Se me u përmend emri flamur të mytke UDB-a, e le mo me qepë flamuj... në përgjithësi organizata jonë ka pasë, veprimtaria e saj ka qenë propagandistike. Me propagandu çashtjen kombëtare, çashtjen shqiptare. Moslargimi nga Kosova, mundësi për shembull edhe të gjitha kanë qenë. Me shkollu vajzat, se atëherë nuk janë shkollu vajzat. Shkollimi i vajzave. Gja që unë motrat e mija... paskam dalë nga burgu i parë në '68-ën. Tri motrat e mija në shpi kanë qenë, kishin qenë. Baba në atë mënyrën e vet.

Igballi ka qenë, që ka qenë ktu, me shami ka qenë {përshkruan me duar shaminë e lidhur poshtë mjekrrës}. E kish kry vitin e katërt. Magbulja e kishte kry vitin e katërt. Meleqin fare s'e kishin regjistruar. Atëherë e çova Magbulen, Igballin i kryti privatisht edhe katër klasë, tetë klasë edhe dy klasë të shkollës të mesme ekonomike edhe e regjistrua në klasën e tretë të shkollës ekonomike. Magbulja qashtu e kryti katër klasë privatisht krejt, e kisha mundësi pak punojsha edhe e regjistroj medicinën e kryti shkollën e mesme të medicinës. Masnej e vazhdoi. Meleqin e regjistrua në shkollë. Domethonë, faktikisht në çdo aspekt organizata kish për detyrë me kontribue në ringjallen e kombit, mos me u asimilue, mos me hupë edhe m'u përgatitë në momentin e duhur.

Anita Susuri: A mundeni me më tregu për këtë organizatën që keni qenë pjesë, diçka ma shumë për ta? Edhe këto parollat, çfarë parolla kanë qenë?

Sabri Novosella: Organizata e ka pasë Komiteti Qendror në krye me Adem Demaçin. E ka pasë Komiteti i Qarqeve. E ka pasë Komitetin e Qarkut të Prishtinës, Mitrovicës, të Pejës, të Gjakovës, të Gilanit, të Podujevës, po. Unë kam qenë i zgjedhur në Komitetin e Qarkut të Prishtinës. Kryetar i Komitetit ka qenë Xhafer Mahmutxhiku, ni veprimtar shumë, shumë, shumë djalë i mirë me tona të mirat. Në përgjithësi kanë qenë tonë djem të mirë. Poashtu edhe ni djalë që me të vërtetë osht' për m'u cekë... krejt ajo, 350 vet na kanë burgosë. Disa femra kanë qenë. Pi krejt atyne veprimtarëve, ata që i kanë marrë kah dy-tre muj në burg, ata që kena vazhdu burgjet, asni nuk ka kalu nana... asnjë nuk u bo spiun i UDB-së. Përkundër torturave, përkundër, për shembull, neve na mytën Fadil Grajçevcin. Bile me Fazli Grajçevcin qelia e burgut, unë kam qenë në qelinë e burgut numër pesë, ai ka qenë qelinë e burgut të Prishtinës numër gjashtë. Deri në gërrhamzën e fundit ia kom ni gërrhamzën, ka vdekë, e kanë mytë. Ni fjalë s'e ka tregu, ni fjalë nuk e ka qitë...

Anita Susuri: Ju keni qenë në [burg] atë kohën kur ai osht' vra?

Sabri Novosella: Bashkë na në organizatë jemi konë, pastaj na kanë burgosë në të njejtën kohë. Bile pak ma vonë veç për të njejtën kohë na kanë burgosë. Pastaj, po ja u them edhe juve që vajza apo si mesat e mija, prej shokve tonë që janë burgosë shtatë prej tyne pasi kanë dalë prej burgjeve kanë qenë të paaftë për me lind fëmijë. Prej torturave të tmerrshme që ua bojshin gjatë hetimeve. Kemi shokë me emra.

Anita Susuri: Po më intereson këto mbledhje për shembull që i keni bo ose rregullat si kanë qenë?

Sabri Novosella: Rregullat...

Anita Susuri: A kanë qenë organizatë e msheftë?

Sabri Novosella: Organizatë krejtësisht ilegale. Dega jonë për njësi i kemi majtë mbledhjet në shtëpinë e Xhafer Mahmutxhikut. E ka pasë përtej pazarit e ka pasë ni shpi, aty banojke te ni mik i veti. Edhe tani

u takojshim gjoja si shokë për ni darkë edhe u mbajshin mbledhjet. Mbledhjet faktikisht u mbajshin sipas nevojës, po për ni si u majke mbledhja edhe u vendoske mas dy jave, mas tri jave u shty atëherë u tubojshim, raportojsim për aktivitetet gjatë asaj kohe, për pranimin e anëtarëve të ri në organizatë. Kështu që, organizata vinte t'u u zgjerue. U bom rreth 350 anëtarë, u bonëm.

Anita Susuri: Si i keni përzgjedhë për shembull anëtarët e juj? Si i keni besu?

Sabri Novosella: Po shif, në përgjithësi ka qenë obligim me njoftë. Nëse s'e njefti personalisht me njoftë dikush i familjes tane. Ma s'pari me njoftë si familje, a kanë qenë bashkëpunëtor të UDB-së a jo edhe me njoftë veprimtarinë e tina si po shkon. Kështu që, në atë, në atë, në ato kushte janë pranuar njerëzit në organizata të reja. Janë bo gabime, janë bo edhe atëherë gabime e na kanë hi spiuna. Na kanë hi spiuna gja që ata edhe na kanë zbulue. Kështu që, ka qenë punë e vështirë. Me të vërtetë ka qenë ni guxim jashtëzakonisht i madh se...

Anita Susuri: Cilat kanë qenë rregullat e juja? Për shembull, aktiviteti kur u dashtë me u zhvillu? A ka pasë orar të caktum a qysh ka qenë?

Sabri Novosella: Sipas situatave, sipas situatave. Për shembull, ka qenë 28 nandori, për 28 nandor vazhdimisht janë ngritë flamuj, janë shkru parulla, ky ka qenë aktiviteti jonë. Ni aktivitet me rraf dikond a me mytë dikond a me bo diçka, apo me rrxu naj diçka absolutisht [jo]. Këto kanë qenë të preme. Pse? Thjeshtë se edhe ktu ka qenë ni ide e Adem Demaçit. Ne faktikisht, ideologjikisht me u ngritë. Thjeshtë m'u ngritë fryma kombëtare, fryma atëdhetare. Se shkau e bojke të vetën. Se na flasim për turq, turq në Ballkan s'ka pasë kurrë. Turq që fillunë këta [të identifikohen] krejt janë të krijunë. Pse? M'u regjistru turk kisha plot lehtësina. Me i regjistru njerëzit turq, jo boshnjak, jo drej e të bir... Kështu që, ka qenë ni situatë tepër e randë, por organizatat politike kombëtare e ka lujt rolin e vet shumë pozitiv. Me rujtë frymën e vet kombëtare edhe m'u përgatitë në momentin e duhur.

Anita Susuri: Cilat kanë qenë parullat që i keni shkru?

Sabri Novosella: Po gjithmonë ka qenë për shembull megjithatë, "Rrnoftë Shqipnia, rrnoftë populli shqiptar", mbi të gjitha, bashkimi. Se Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, emrin e ka pasë. Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve. Kështu që, si ideal, si ideal ka qenë shlirimi dhe bashkimi edhe parullat në përgjithësi në qat' përmbajtje janë shkru.

Anita Susuri: Tash po më intereson kjo qepja e flamujve...

Sabri Novosella: Po.

Anita Susuri: Kah ka ardhë ideja edhe qysh osht' formu krejt, qysh ka ecë krejt kjo?

Sabri Novosella: Puna e flamujve. Kështu, ideja ka qenë, ka majtë, unë nuk di ndoshta ata e kanë marrë edhe prej Adem Demaçit. Veç unë edhe me Ademin kom kontaktue po edhe faktikisht isha anëtar i Komitetit të Qarkut. Në Komitetin e Qarkut, aty u epke propozimi, u jepke ideja edhe u dajshin detyrat aty. E unë si rrobaqepës m'u dajke detyra për qepje të flamujve.

Anita Susuri: E ju në familje po më doket nuk keni tregu, nuk e ka ditë kërkush, as nana juj as bashkëshortja se çka jeni t'u bo, çfarë aktiviteti?

Sabri Novosella: Kështu, kështu. Askush s'e ka ditë. Askush s'e ka ditë. Bile, kur kisha m'i qepë flamujt, se unë në shpi i qepsha, e kom pasë makinën. E çojsha Safetën, shoqen, te nana e vet ni natë-dy netë, kryjsa puntë. Po nifarë mënyre as unë s'i kom tregu [Selatinit](#), as Selatini s'më ka tregu mu. Por, çka qysh si. Por, në qepjen e flamujve më nimojke Selatini, më nimojke Selantini.

Anita Susuri: Po më doket që mrena natës i keni qepë...

Sabri Novosella: Gjithmonë, gjithmonë. O në rregull. Mrena natës u qepshin, mrena natës u qepshin, mrena natës u shpërndajshin. Çdo gja natën, çdo gja natën shkojke.

Anita Susuri: Po tash po më intereson edhe kjo, kuq e zi, ku e keni marrë materialin? A ka qenë rrezik se ato ngjyra kanë qenë identifikuese.

Sabri Novosella: Ni vend u blejke ni pëlhurë e zezë, tjetër vend u blejke ni pëlhurë e kuqe, që mos me konë... mundësisht mos m'u zbulu. Gja që edhe prej tyne nuk jemi zbulu. Prej atyne shitoreve ku blehej materiali nuk jemi zbulu prej tyne. Gja që gjatë hetimeve ka që asni prej, asni akuzë s'e kem pasë.

Anita Susuri: E qysh ka ndodhë pastaj? I keni dorëzu ato edhe? Apo keni marrë pjesë edhe në ngjitjen e atyne?

Sabri Novosella: Unë s'kom marrë pjesë. Pasiqë unë i qepsha s'kom marrë pjesë në ngritjen e flamujve. Po tash u caktojshin, për shembull, u caktojshin, çdo gja u krynte natën. U pshtjellshin, kështu në torbë gjoja që ma, ka marrë material a ushqim a diçka edhe u shpërndajshin nëpër tjera, nëpër tjera qytete. Ama, ka qenë gjithqysh mrena ni natës m'u ngritë në tanë Kosovën. E kena pasë ni informatë që edhe në Shkup janë ngritë.

Anita Susuri: E qysh ka qenë reagimi juj? Qysh ju ka dokë juve kur i keni pa ato flamuj?

Sabri Novosella: Po ta them të drejtën...

Anita Susuri: Sigurisht mrena kohës të shkurtë i kanë heqë ndoshta.

Sabri Novosella: Mrena afatit të shkurtë i kanë hjekë. Po ka qenë kënaqësi e madhe, kënaqësi e madhe, se e dishim që rreziku ishte shumë i madh.

Anita Susuri: A kanë qenë nëpër institucione të ngritura apo...

Sabri Novosella: Vallahi, gjithkund, gjithkund. Për shembull, ka pasë edhe... se vishin në mëngjes, vishin në mëngjes me falë sabahin... edhe nëpër shtyllat afër dyrve të xhamiave. Ku janë konë xhamiat ata vishin... se ata në saba, tash si e pajke UDB-a e merrke e hiqke. Që me pa njerëz sa ma tepër [flamuj]. Po si e pajke njani e merrke vesh krejt Prishtina, "Sot janë shpërnda flamuj". "Kush?" "Filani e ka pa, ky e ka pa". Ashtu që ndikojshin shumë.

Anita Susuri: E ju qysh e keni pa reagimin e njerëzve?

Sabri Novosella: Unë them kështu, me burgosjen e parë të Adem Demaçit, shpirtnisht në Kosovë osht' bo ni ndryshim. Për shembull, u përhap me të madhe propaganda mos me shku në Turqi. U përhap me të madhe [vetëdija] ky është vendi joni këtu. Ka me të madhe, ni ditë kena m'u shlirue. Kështu që, organizatat ilegale kanë pasë rolin në Kosovë.

Anita Susuri: Ju thatë si rrobaqepës e keni pasë, e përmendet ma herët që kto materialet të ndryshme i keni qepë edhe mrena teshave? Mrena setrave për shembull?

Sabri Novosella: Jo, jo.

Anita Susuri: A ju kuptova mirë a...

Sabri Novosella: Jo, jo. Letrat që ua çojshim në Shqipni, Sali, Ajet Alisë, Sali Shatrit e Ali Boletinit. Po aty në përgjithësi lidhja ish majtë ma së forti mes Ajet Alisë dhe Sali Shatrit, po kanë qenë burra shumë të mirë. Masanej kur dola unë, kur u shliru Kosova, Shqipnia, shkova e pashë e rrisa me to. Kom pasë nderin. Kanë vdekë... kështu që unë ia qkeshpa këtë pjesën mrapa setrës edhe mrena ktu osht' ni pamuk mrapa aty e shtisha letrën, aty e rregullojsha. Tashi e qepsha, e ndreqsha edhe i merrke Mark Mërturi i veshke edhe... plot që e keni në fotografi edhe Mark Mërturin aty. Aty letrat u bajshim në atë mënyrë.

Anita Susuri: Hera parë që, po menoj kur jeni burgosë ka qenë viti '64...

Sabri Novosella: Me 8 qershor të vitit 1964 jom burgosë për herë të parë.

Anita Susuri: A mundeni me shpjegu krejt këtë? Qysh ka ndodhë? Edhe krejt domethonë qysh e kujtoni ju?

Sabri Novosella: Burgosja ka ndodhë kështu. Ni... pra me 8 qershor muna me thanë kah ora katër, pesë osht' rrethu shpija edhe kanë hy mrena UDB-ashët. S'pari më kanë kërku mu, më kanë lidhë, m'i kanë vu prangat. Ni milic rrijke me mu, ata hinën e hallakatën shpijën krejt komplet. Tani nana u çue, qikjo nana Naile e Banjës "Nana Naile" edhe me të vërtetë në jetën time s'kom bo gja pa e vetë atë. Për organizatë literalisht asgja s'i kam tregue. Po me nënkuptime po. Çka m'ka thanë goja e saj kurrë ndryshe s'më ka dalë. S'e kam bo vetëm si respekt ndaj nanës, mbi të gjitha çka më ka thanë ashtu më ka dalë.

Atë ditë më morrën milicët, po ju them policët, njëri për ni dorë, tjetri për ni dorë. Durtë e lidhme. Ishin disa tjerë. Nana u afriu tha, "Te kapi për qafe", e shtyjnë nanën. Nana me dy durtë, "Djali jem me faqe të bardhë m'u kthefsh". Nëpër tortura ma të tmerrshme kur m'u kujtojke fjala e nanës, "M'u kthefsh me faqe të bardhë", a muna m'ju kthy nanës me faqe të bardhë? I dekun i kthehna, me faqe të zezë nuk i kthehna. Kalojshin ato ditë burgu. Se tash s'pari kam nejtë tre muj vet në qeli deri në gjykim. Tani mas gjykimit na edhe me shokë tjerë, me katër-pesë shokë...

Anita Susuri: Juve ku ju kishin pasë zbulu apo nuk e dini?

Sabri Novosella: Jo e di. Më kanë zbulu ni Qerim Pozhegu. Tash kom informatë që u dekë. Veç, po, nëpërmes ni shokut, ni anëtari tjetër. Ai s'e ka ditë, s'e ka njoftë. E pruni te unë, u krye. Ai masanena ish konë spihun i UDB-së, e ka zbulu.

Anita Susuri: Ai ka qenë spiun?

Sabri Novosella: Po, spiun i UDB-së. Bile, veç, beso në Zot s'më hjekët prej mendje kurrë a, po qysh e bon bre burri ashtu. Me siguri ka qenë rreth 40-50 vjeç e unë çka jom konë djalë 19 vjeç, 20 vjet. Punojsha nër xhaminë e madhe, ka qenë ni rrobaqepës aty i Gjakovës. Merre me mend tash, ai e dinte kur dal nga puna. Tash ish dalë, unë kur dalë nga puna ky ish dalë te Xhamia e Çarshisë knena e në anën tjetër të rrugës Rela. Rela ka qenë ni polic i, ni kriminel. I ka pasë vra dy shqiptarë në pazar. I njoftun si kriminel, vrasës. Merre me mend! Unë dola prej ktuhit, ky ish pshtet aty, m'pa mu. Ia bojke atij {me lëvizje koke dhe me sy demek doli nga puna}. Zbulimi jem.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Herën e parë kur keni qenë në vetmi, tre muj...

Sabri Novosella: Po, po. E tash...

Anita Susuri: Në cilin vend keni qenë? Në Prishtinë?

Sabri Novosella: Në Burgun e Prishtinës, në Burgun e Prishtinës. Tash u bo burg muze, a diçka u bo diçka...

Anita Susuri: Po, muze.

Sabri Novosella: Bile, merre me mend as s'më kanë thirrë të marrë pjesë. Isha në qeli...

Anita Susuri: Qysh ka qenë në atë kohë Burgu i Prishtinës?

Sabri Novosella: Po qiky burg ka qenë. Ka qenë burgu...

Anita Susuri: Kushtet për shembull?

Sabri Novosella: Kushtet. Po kushtet burgu. Tri herë ushqim na kanë dhanë, ato ishin të burgut. Edhe...

Anita Susuri: A keni pasë tortura?

Sabri Novosella: Tortura të tmerrshme. Tortura të tmerrshme, qysh jo. Gja që, Fazli Grajçevcin e mytën krejt. Kallxova, s'di sa kanë metë të paaftë për martesë, për me pasë fëmi në tona antë e Kosovës. Po qëndrimi ka qenë shumë i mirë, [se]pse ishim shku me vdekë, ishim shku me vdekë. Dhe e kisha msue, ndoshta edhe si fëmi ni poezi të Migjenit. Nëse s'e kam harru krejt:

[Reciton poezinë e Migjenit]

“Nëpër hekra të kryqëzumë të dritarës teme e shof qiellin në katërdhetë copë. E shoh diellin sa ni pare e serrme aq osht', aq osht' larg dielli nga e jemja gropë. Kjo gropa jeme e ka emrin burg dhe burgun e dini nuk osht' për dëfrim. Por sa kthehem mrapa shoh hijen, por sa kthehem mrapa e shoh hijen e smutë, por sa kthehem mrapa e shoh dritën e smutë dhe hijen time t'u varë në mur. Si në kërcim ligji, si ni dajak tërbehem dhe urrej pa masë hijën, dritën, hekrat dhe ndjej vetën luan të ndryer në kafaz”.

Beso Zotin, aq ka qenë e fuqishme kjo për shembull në ato situata tepër të rana që e ndjej vetën luan të ndryer në kafaz. Kështu që, i kena përballu ato me vështirësi tepër të mëdha. Vet dënimi nantë vjet burg që...

Anita Susuri: Domethonë, pas tre mujve juve ju kanë...

Sabri Novosella: Na çunë në gjykatë, po.

Anita Susuri: Qysh jeni dënu për shembull? Qysh ka qenë qajo ditë?

Sabri Novosella: Po ajo ditë ka qenë, na morën si lopve na lidhen pranga na çunë. U kryjnë ato formalitete. Ka qenë gjykatës Tahir Dibrani, gjykatës. Kurse, prokuror ka qenë ni serb. Edhe më duket mrena pesë-gjashtë dite u kry gjykimi. *Tap, tap tap* {onomotope} u kry gjykimi edhe na dhanë... se në grup me Adem Demaçin u dënum dymdhetë vetë. Ademi 15 [vjet], Haxhi Shala 14, Xhafer Mahmutxhiku dymdhetë, Avdyl Lahi dhjetë vjet edhe tre u dënumë kah nantë vjet. Aty ka qenë edhe unë u dënova nantë vjet, Tefik Sahiti u dënu nantë vjet edhe Tefik Straja i Turqisë ka qenë aktivist. Se edhe atje kem pasë degën. U nxu këtu edhe u burgos. Edhe ata e dënunë nantë vjet, po.

Anita Susuri: A ka qenë kjo koha kur ju kanë dërgu në Goliotok?

Sabri Novosella: Mas dhetë muje na kanë çu në Goliotok.

Anita Susuri: E pas Prishtinës ku keni qenë? Në cilin burg?

Sabri Novosella: Mu më kanë marrë prej Burgut të Prishtinës edhe na kanë shti ni, ni xhip ka qenë më duket me dymdhetë vetë. Ka qenë shoferi, dy policë edhe kemi qenë nantë të burgosun. Prej atyne nantë të burgosun tanë kemi qenë të lidhun kah dy vetë për dore edhe mrena. Ashtu si e thashë, kur u nalë te Burgu i Nishit. Kur u afrum te dyrtë u çelë dera e burgut ata hekrat. Ato fjaltë që i tha Adem Demaçi unë i përsërita. Po tash, të gjithë ata i futën në burg, mu nuk, mu s'më pranunë aty në burg. Më kthyn prej burgut në Prishtinë me atë makinë edhe ni muj më majtën në burg këtu, pas ni muj dite më çunë në Goliotok.

Anita Susuri: E po më intereson ky udhëtimi deri në Goli Otok qysh ka qenë? Edhe a keni ditë ju që po shkoni në Goliotok?

Sabri Novosella: Absolutisht. Na kemi qenë kufoma të gjalla. Për asgja s'kem ditë. Veç të lidhun dorë për dore. Ka qenë ni, ni serb, ish konë ushtar e në ushtri ish burgosë. Kish qenë në Burg të Prishtinës e na lidhën dyve dorë për dore me ata hekrat, *lisica* [Srb.: pranga] ju thojshin. Dy policë me ne edhe na çunë në burg të Goliotokut.

Anita Susuri: Qysh ka qenë udhëtimi?

Sabri Novosella: Me tren. Me tren ka qenë deri në, më duket deri në Beograd. Në Beograd u ndrru treni. Atëherë na çunë deri në Zagreb. Më duket që prej Zagrebit tani na çunë me kerr të policisë, a nuk di, se Goli Otoku ishte ni ishull mes detit.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Po, ishit t'u na tregu për arritjen në burgun e Goli Otokut.

Sabri Novosella: Po, na çunë në Goli Otok. Atje ni muj na vendosën... se faktikisht në Rijekë kishte qenë ni dhomë e burgut. Aty u bojke ni sasi bukur e madhe e të burgosurve politikë që vijshin, të burgosurve që vishin nga të gjitha anët e Jugosllavisë. Na ngarkojshin me ni anije edhe na çojshin në burg. Aty na çunë, ishte ni paraburgim ni muj ditë na lanë aty. Mas ni muj dite na caktun nëpër secilin vendin e vet. Mu më çunë, aty ishin të ndame me ku punohej për shembull. Mu më çun me ni pavijon ku ishte fabrika e zdrukthtarisë. Tani aty kam punu prej fillimi deri në mbarim, kom fillu aty. Jeta e burgut ish jetë e burgut ish.

Anita Susuri: A mundeni me na përshkru qysh e kujtoni atë burg? Qysh osht' dukë ai burg?

Sabri Novosella: Edhe interesant, masanej, mas luftës e kishin pasë organizue ni vizitë. Tash ai osht' burg muze.

Anita Susuri: Po.

Sabri Novosella: Po tash ishte Burg Goli Otok vjen nga serbishtja... serbishtja-kroatishtja. Ishull i zhveshun, vetëm gurë kurgjo tjetër. Kanë qenë shpijat e të burgosurve. Ato, qato, sallat, burgu. Aty ai kish qenë burg edhe ma parë. Aty kishin qenë shumë edhe infobyristët. Aty Tita i kishte shkatërru nja pesë-gjashtë mijë oficer serbë, malazezë, në ato burgje. Atëherë, ne aty vazhdum jetën, jetën e të burgosurve. Kur shkum, u bonëm disa shqiptarë, kish pasë për vepra tjera. Po për aktivitet politik, na organizata jonë ishte Shefqet Jashari, Teki Dervishi, isha unë. Tani ka qenë edhe Shefki Muçaj, Haxhi Zyba, baba i këtij aktivistit të Vetëvendosjes.

Ka qenë ni Skender Kabashi i Pejës, Shaban, edhe dy... kemi qenë afër kështu të burgosurit politikisht edhe kishim ni shoqni shumë të afërt. U murrëm vesh mes veti të tregojmë edhe okupatorëve që nuk jem rrugaqa, nuk jem lahpera. Jo s'punoj, jo s'boj këtë. Secili punën që na ka caktu me ni kujdes shumë të madh me ru shëndetin, me ru vetën edhe me kalue. Tashi në kohën e lirë edhe kishim mundësi aty me nejt bashkë, nëse doni. Po shumë, shumë i kena kushtu randësi leximit, se edhe ka qenë biblioteka e burgut, kish qenë e na binin libra, na lejonin libra. Unë At Fishtën komplet e kom lexu në Goli Otok, në burgun e Goli Otokut. Kemi, marrëveshje kem pasë mes veti ia kem kushtu shumë shumë leximit.

Anita Susuri: Sa orë në ditë keni punu?

Sabri Novosella: Ë?

Anita Susuri: Sa orë në ditë keni punu?

Sabri Novosella: Si përjashta, tetë orë në dite. Tetë orë ka qenë dita. Po në ni anë të burgut ka qenë ato sallat, qato si me ju thonë, ku flenim. E në anën tjetër kanë qenë fabrikat. Na çonin me rresht, me rresht shkojshim, vishin. Rregull i burgut, rregull i burgut.

Anita Susuri: E qysh kanë qenë qelitë e burgut? Qato sallat?

Sabri Novosella: Ato nuk kanë qenë qelia, ato kanë qenë për shembull, me siguri kah 15-16 vetë ni dhomë, ni... ka qenë si salla qashtu. E ka qenë krevetat tre kat, katër kat. Njo mi njo ata krevetat. Kemi flejt qaty. Dy herë në javë na kanë çu në bajë me u la. Na kanë, dy herë në javë na kanë ndrru çarçafat. Ushqimi... qe besa, kështu, burg ka qenë veç kur jam shku në Shqipni gjendjen e popullit burgjet s'i kam pa. Veç populli gjendjen shumë ma të vështirë ekonomike punëtori në Shqipni, se ne që e kem pasë në burgun e Goli Otokut. Diqysh Kroaci ka pasë policë e ksi ka pasë serbë, po ka pasë edhe kroatë. Veç interesant kishin ni sjellë të mirë ndaj nesh.

Anita Susuri: A ka pasë dhunë gjatë qasaj kohe kur jeni dënu?

Sabri Novosella: E tashti varësisht. Dhuna nëse ke bo diçka. Na me vjedhë nuk vjedhshim, kumorë nuk lujshim. Tash të më falni në shprehje, po foli me vajza të mia, kishte homoseksualizëm, kishte... te na s'ndodhshin ato sene. Ishim me të vërtetë... ne nuk bishim në konflikt me ligjet e atyhit. Për...

Anita Susuri: Cilat kanë qenë për shembull rregullat e burgut? Naj rregull ma...

Sabri Novosella: Ka qenë, kemi qenë në burg të izolum prej familjes. Ni letër ke pasë të drejtë me ia çu familjes, kur vijke ajo letër... osht' ni Azem Makolli e ka, e ka shpinë përmi hekurudhë, tash po i thojnë Lagjja e Trimave. Edhe ai ka qenë me ne aty në burg. Ai e kishte vra ni serb, e kishte nxjerrë hakun e gjyshit edhe niherë, pa kurrë ni arsye ni polic, kumeditë e dinte. E boni disa fjalë e rrafën shumë keq, shumë keq e rrafën. Me to me folë nuk u konë keq. Osht' bablok ashtu veç ka pasë qëndrim të mirë, shumë ka pasë qëndrim të mirë. Kemi qenë ni grup i shokve në burg, thjeshtë u morëm vesh mes veti. T'i tregojmë okupatorit që nuk jem rrugaq, që s'kem pasë çka të bojmë, hajde të bojmë diçka. Jo, kemi qenë njerëz të punës, kemi qenë njerëz të shkollës, kemi qenë njerëz... edhe na kanë burgos, na kena kërku të drejtat tona, na kena kërku ata që na takon edhe kena pasë qëndrim. Përndryshe, burg. "Dhe e dini se burgu s'osht' për dëfrim. Prandaj, burgu im është shumë shumë i ultë".

Anita Susuri: A keni pasë vizita?

Sabri Novosella: Kena pasë të drejtë niherë në mujt niherë. Po niherë në gjashtë muj. Ma pak na vishin se shumë larg. Tani masanej mjetet e komunikacionit kanë qenë tmerr atëherë. Me trenat, tren mas treni. Vijke vllau, nana, shoqja me djalë...

Anita Susuri: A ju kujtohet, po menoj, sigurisht ju kujtohet. Qysh kanë qenë këto takime? Prapa grilave sigurisht.

Sabri Novosella: Ç'është e vërteta, ktu kanë qenë prapa grilave kurse atje ishte ni dhomë. Vijke ni polic i burgut edhe ni shqiptar m'ju përkthi. Ç'është e vërteta ai shqiptarë që përkthejke gjithmonë ka qenë spiun, që ka pasë spiuna. Po nga të burgosurit politikë s'ka qenë asnjë hiç. Ka pasë që kanë bashkëpunu me ata edhe ata vishin gjoja se si përkthyes, po faktikisht me dëgju çka po diskutojmë, çka po folim edhe na ishim të kujdesshëm. Nuk thojshim gjo. Po lypshin... e thashë edhe ma parë. Burgu për neve nuk ka qenë tmerr. E kem përjetu stoikisht. Na i kem thanë shkaut, e dum Kosovën është e jona, ata na kanë burgosë. Kanë qenë ato vdekje, ato që kanë qenë. Vetëm Fazli Grajçevcin na kanë mytë, tjetër kanë pasë qishtu pasoja shëndetësore edhe kanë qenë ditë të vështira. Kem lanë nuse të reja, kem lanë fëmi, po. Shoqja ime gjashtë vjet ka jetu pa mu, në burg. Pas...

Anita Susuri: A keni pasë fëmi atëherë?

Sabri Novosella: E kom pasë. Në burgun e parë e kom pasë Ilirin që e kom lonë gjashtë mujsh. Në burgun e dytë e kom pasë Dardanin e kom lanë katër mujsh.

Anita Susuri: Ju gjatë kohës kur keni qenë në burg në Goli Otok, thatë që prej nantë viteve janë zbritë gjashtë vite për shkak të ndryshimit të sistemit...

Sabri Novosella: Po.

Anita Susuri: Nëse mundeni për këtë...

Sabri Novosella: Po, u ra Rankoviqi. Çdo... edhe '48-ën... edhe kur ra Rankoviqi edhe vazhdimisht çdo goditje që ju ka dhanë Tita serbëve, armiqve serbë për ne shqiptarë ka qenë fitore e madhe.

Anita Susuri: Qysh e keni pritë ju atë lajm që ma pak keni me qëndru?

Sabri Novosella: Po valla me të thanë të drejtën ma fort jena gzu kur u ra Rankoviqi, se kur na kanë hjekë vjet (qeshë). Ma shumë jena gzu kur u ra Rankoviqi se që na zbritën vjet e burgut. Përndryshe e merrshim me mend që kanë me na zbritë.

Anita Susuri: A keni pasë të drejtë aty edhe gazeta me lexu? A ju kanë ardhë gazetat? Informacionet?

Sabri Novosella: Gazetat po. Gazetat, televizionet kanë qenë, po. Edhe gazetata se ka qenë biblioteka. Tani në bibliotekë kanë ardhë gazetata jugosllave, të rregullta kanë ardhë aty. Edhe shtypin e kem lexue.

Anita Susuri: A ju ka ndodhë, po më duket juve, që nuk ju ka njoftë djali kur ka ardhë me ju vizitu në Goli Otok?

Sabri Novosella: Po jo, ai djali ka qenë, djalin e kom lonë shtatë mujsh. Kur u ardhë mu s'më ka njoftë fare normalisht.

Anita Susuri: Qysh e keni përjetu kta?

Sabri Novosella: Po, po të thom të drejtën (qan)...

Anita Susuri: Nëse nuk doni me folë për këtë në rregull.

Sabri Novosella: Jo, jo, jo kështu. Kur na nisën me na çu për burg të sillën në pranga. Edhe nuk jam poet. M'kanë shpallë filozof të filozofisë dhe filozofisë së historisë. I kam 21 libra dhe lexoj jashtëzakonisht shumë. Tjertë i kanë shkru për mu 16 libra. Mirënjohjen masi kishte vdekë, ni shok i tij e kishte botu librin e tij. Tash prapë më njoftun, ni poete edhe ni shkrimtare që e kanë shkrujtë ni libër. Kom radhitë, bile ju çova edhe njo, atë ditë që e mora vesh që u dekë kjo amerikanja që na shpëtoi... Po, e shef aty e kom, ia kom thurrë nja katër-pesë vargje.

Anita Susuri: Qysh ka qenë koha kur keni marrë vesh, domethonë thatë që ma shumë jeni gzu që ka ra Rankoviqi...

Sabri Novosella: Po.

Anita Susuri: Po qysh ka qenë pastaj procedura me u liru prej atij burgu? Me u kthy?

Sabri Novosella: E tash kështu. Procedura ka qenë kështu... se udhëheqësit e Kosovës janë nda. Udhëheqësit, bashkëpunëtorë të serbo-komunistëve dhe kanë qenë bashkëpunëtorë të Titos të kroato-sllovenëve. Tash pasi ra Rankoviqi, kryetari i gjyqit suprem ishte ni shqiptar... që interesant prej që e kom marrë vaksinën e dytë kam problem me kujtesë, po harroj. Ai boni kërkesë për, për rigjykim. Në rigjykimin tonë të gjithëve na zbriti vite. Ashtu Adem Demaçit pesë, mu gjashtë, dikujt katër, dikujt... pesë a gjashtë qishtu. Faktikisht na zbritën dënimet. Pse? Edhe në atë kohë edhe ata që luftojshin nga pozita, nga pozitat shtetnore të okupatorit, ni pjesë e tyne kanë qenë atëdhetar. Kanë bo aq sa kanë mujtë. Kanë bo aq sa kanë mujtë. S'po më kujtohet tash kush ka qenë kryetar i gjyqit suprem. Me kërkesën e tina u bo rigjykimi. Në rigjykim na kanë zbritë dënimet. Edhe tash masanej na erdhën vendimet që kështu kështu. Na ndanë edhe na lirunë nga burgu.

Anita Susuri: Qysh jeni kthy prej Goli Otokut? Vet apo?

Sabri Novosella: Atëherë privatisht. Faktikisht, faktikisht nifarë pagese të atyne që punojshim e s'di qysh. Ke diçka që na patëm do lekë, do pare edhe i blemë teshat. E pagum rrugën me tren erdhëm. Veç kur më kanë pa te shpija, që hina në shpi.

Anita Susuri: Nuk e kanë ditë këta?

Sabri Novosella: Hiç s'e kanë ditë, se telefona s'kishim.

Anita Susuri: Qysh ju kanë pritë?

Sabri Novosella: Po normalisht që pak në mënyrë befasuese, normalisht gëzim.

Anita Susuri: A ka pasë ndonjë... festë sigurisht osht' bo? Naj aheng?

Sabri Novosella: E tash ato ahengjet janë bo bre te ne. Sidomos ditëve të festave na kena pasë ditën e flamurit e kto i kena pasë gjithmonë. Gjithmonë i kem festu. Ma mirë janë festu atëherë sesa tash. Ma të afërt kemi qenë atëherë se tash. Shumë interesant!

Anita Susuri: Çfarë kohe keni qenë kur jeni kthy? A ka qenë vjeshtë a?

Sabri Novosella: Për besë nuk e die. Nuk më kujtohet. Jo, jo, s'ka qenë, nuk ka qenë dimër.

Anita Susuri: Ka qenë viti '68 më duket.

Sabri Novosella: '68 po. Jo, ka qenë muji dhjetor. Po po ka qenë dhjetor, qitash po më kujtohet.

Anita Susuri: '68-ën domethonë atëherë janë bo veç ato demonstratat që kanë qenë...

Sabri Novosella: Për demonstrata këtu kam qenë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë qajo?

Sabri Novosella: Demonstrata e '68-ës me demonstratat e '81-shit kanë shumë shumë dallim. Demonstrata e '68-ës u bonë, ma së pari ishin demonstratat që ndodhshin mas ramjes së Rankoviqit. Kishte marrë frymë, kishte marrë frymë pak Kosova. Ma nuk ishte ajo Kosovë. Kur jom ardhë unë nga burgu s'e kom gjetë Kosovën qysh e kom lanë, shumë shumë ndryshim. Atëherë u bonë demonstratat në tona anët e Europës. U bonën në Zagreb, u bonën në Beograd. Demonstratë të studentëve.

Tash për ato demonstratat edhe ne aktivistët ishim në kontakt. Posaçërisht Metush Krasniqi, Hyrije Hana, Ali Boletini, ky, heronj të kombit janë. Bisedojshim qysh si tek krejt. Erdhëm në përfundim me

organizue demonstratë. Tash atëherë ne propozunë, po ato ishin vet të gatshëm. Faktikisht e krijim ni numër prej nantë aktivistave, djem të ri qishtu shokë tonë. Selatini ka qenë aty, Osmon Dumoshi, Adil Pireva, Ilaz Pireva, Xheladin Arakaliu edhe murr vendim me organizu me 20 e... jo me 28 që mos të jem bash me 28, se mos me 28-tin gjithmonë policia rrike gati. Me 27 [nëntor], në ora katër. U mor vendimi për me organizu demonstratat, po studentët me udhëheqë. Me konë demonstrata të studentëve.

Ismail Dumoshi ka qenë shumë aktiv në ato... u murr vendim me organizu. Këta djemtë të gatshëm, mezi s'pritën. U organizunë demonstratat. Për ato parulla, për ato janë marrë vendime qashtu bashkë. Bile, për shkrimin e asaj që u lexue unë shkova e bleva maqinën për flamuj kto sene, gjithmonë ishim. Demonstratat fillunë simas e parapamë. Ni natë përpara na thirri në darkë ky Adil Pireva. S'e di a keni, osht' mirë me folë me të se shumë osht' djalë i mirë. Adil Pireva në shpinë tina na boni ni darkë edhe faktikisht qajo mramje përfundimtare që u morëm [vesh]. Ishin ata të nantit, më thirrën edhe mue.

Atëhere të nesrit në dyqanin tim... tash vendosëm që ne ish të burgosurit mos me dalë në demonstrata. Por, Shefqet Jasharin s'pat që e nalë. U vesh u kamuflu dul ai në demonstrata. Kurse në dugojë time Metush Krasniqi, unë isha në dugojë, Ali Boletini, Hyrije Hana. Prej fillimit deri në mbarim se e kisha dyqanin midis Prishtine, te, kjo tani osht' kjo shtëpia e mallrave e vjetra, e madhja.

Anita Susuri: Gërmia.

Sabri Novosella: Po Gërmia. Aty afër e kisha dyqanin. Po tash do armë i prunën, do armë me, që eventualisht mos po ka naj rast dikun m'u përdorë arma. Eventualisht edhe në dyqan timin ato u vendosën. Masi u vra Murat Mehmeti atëherë edhe Metushi me kambngulje, se e dishim armë s'bon me përdorë. Se na i vrasim dy, ata na vrasin dy mijë, ata mezi s'presin. Kështu që, ato armë i majtën në dugojë temën, në dyqan temin aty. Edhe bile masi u vra Murat Mehmeti erdhën aty Muharrem Musliu, Afrim Loxha që na e vranë Afrimin, Gani Graca i morën ato armë. Vazhdunë, u zhvillunë demonstrata jashtëzakonisht të fuqishme, njëra. Ishin demonstrata e kishin ni arsye e kishin ni logjikë, u bo në tona antë demonstrata, a po merr vesh. Edhe Kosova dul me demonstrata të veta. Studentët, faktikisht dulën studentët e Kosovës. Për çka? Se demonstrata shumë të arsyeshme...

Anita Susuri: Çka ishin kërkesat për shembull?

Sabri Novosella: Duam, duam shkolla, duam kushtetutë, duam republikë, duam krejt këto. Bile, gjatë demonstratës dulë parulla, "Republikë, Kushtetutë! Ja me hatër, ja me luftë!" Ajo u përdorë shumë. U zhvillunë ato demonstrata edhe patën ni jehonë shumë të madhe dhe shumë pozitive. Diçka krejt tjetër ken me demonstratat e '81-ës. Pasiqë ato ndodhën në situatë kur ju dha thika Kosovës, u bo nami u bo. Kurse ato demonstrata ishte ajo fryma hala mas Rankoviçit edhe punohej për Kushtetutën e '74-tës.

Sidomos ato që u bon në '68-ën, mas gjashtë vjete erdh Kushtetuta e '74-tës. Kushtetuta e '74-tës ishte shpëtim, ishte fitore e madhe për gjithë popujt. Jo serbët në Jugosllavi, po posaçërisht për ne u bo

shumë mirë, u bo shumë mirë. Se faktikisht... E tash ne kur, këta, kur u zgjedh dora e Enver Hoxhës me themelu Organizatën Marksiste-Leniniste të Kosovës, që e themelunë me Hydajet Hysenin, me Kadri Zekën, me kit Jakup Krasniqin, e tjerë. Edhe kjo faktikisht, çka po doni? Me pru sistemin e Stalinit e të Enver Hoxhës me pru në Jugosllavi a? Po ishte jashtë çdo logjike. Sot qato qëndrime i kanë, sot qato qëndrime i kanë. Kjo osht' tmerr. Kjo tmerr, ju lutem.

Qitash derisa ka vdekë Metush, deri sa na mytën... e burgosën Metush Krasniqin, me tortura ma të kqija e kanë mytë. I kanë thanë spiun i UDB-së, jo më falni, spiun i Amerikës. Po i çon CIA e Amerikës po i çon pare për me maru shpinë. Ai e pat' shitë do tokë atje. Pse? Ai thojke, "Pa Amerikën nuk mund të çlirohemi. Pa Amerikën nuk mun të çlirohemi". Tona shkrimet e mija, tona thanjet e mija, tonat... edhe kemi qenë mbi të gjitha edhe vizionarë. Po edhe kemi qenë të bindun se nuk ka mundësi m'u përballue Jugosllavia, Serbia, Rusia pansllaviste, pa Amerikën. Kjo ka qenë ajo këmbëngulëse ajo puna jonë.

Edhe gjatë luftës, lufta, janë bo dy lufta. Ni luftë ju ka dashtë Serbisë, në Kosovë që me dalë Millosheviqi, me dalë Serbia, ne po luftojmë kundër terroristëve, ne po luftojmë kundër dhunuesve. Ne, faktikisht mos me lonë shqiptar në Kosovë me parullën s'e po luftojmë kundër terrorizmit. Kurse, krahu tjetër që simbolizohet me Adem Jasharin ishte që e bonte luftën faktikisht, se kjo luftë i duhej edhe Amerikës. Me ia hapë derën Amerikës. Adem Jashari, që ishte faktikisht edhe kjo e ka historinë e vet. Se grupin e parë, grupin e dytë, grupin e tretë që i kena çu m'u përgatitë në Shqipni, i kena përgatitë. Faktikisht na e kena organizue. Imer Berisha, Shaban Mlodhi, e tjerë. I ka financue kryeministri Bujar Bukoshi. Ka thanë, s'ka thanë. E vërteta me dokumente osht'. U përgatitën.

E tash sakrifica e Adem Jasharit osht' tamam e ngjashme me ata që shpjegohet për Jezu Krishtin. Jezu Krishti shkoi në vdekje të sigurt për me jetu krishtërizmi. Adem Jashari me 60 anëtarë të familjes shkoi në vdekje të sigurt për me jetu kombi shqiptar. Faktikisht këto lufta, këto sakrifica ia hapën dyrtë NATO-s, ia hapën dyrtë Amerikës erdhën edhe na shpëtunë. Pse raporti forca vet, na e bojmë vet. Po ti sun e bon vet, se raporti forca nuk osht' i njejtë që me mujtë ti m'u shlirue prej Jugosllavisë.

Edhe sot, jo ne bojmë... për shembull, unë kom shkru libër kundër Albin Kurtit po para 14-ten. Se mu shtatë herë më kanë dënu me vdekje, po se di e kam ni fat, nuk e di. E tash ky syri o popullit m'kish dënu me vdekje se m'i ka dhanë Enver Hoxha... Ibrahim Kelmendi në librin e tij si si njeri i Beogradit, Enver Hoxha m'i kishte dhanë ni milion dollar me luftu kunra Amerikës e unë jom bo spiun i Amerikës. Kurse kta, syri i popullit m'kishin akuzu për dy milion dollar m'i kishte dhanë Enver Hoxha me luftu kundër Amerikës e unë jom bo spiun i Amerikës. Po t'ju thom more pa Amerikën s'bon. Pa Amerikën nuk bon.

Se unë e kom librën, "Pushtuesit ballkanikë dhe pushtuesit jashtë ballkanikë", pushtuesit ballkanikë sllavo-grekët, ortodoksët për ne kanë qenë, janë dhe kanë me qenë deri në ditën e kijametit vdekje. Pushtuesit jashë Ballkanit, të gjithë pushtuesit jashtë Ballkanit, osmanët, austro-hungarezët,

gjermanët, italianët, evro-amerikanët janë frymëmarrje, janë shpëtim i joni. Kjo është e vërteta. Kështu që, ne e kemi ditë se Kosova nuk mundet m'u shliu, as Kosova nuk mundet me rujtë pavarësinë pa mbështetjen e botës euro-amerikane, katolike, protestane, pa NATO-n, pa Amerikën. Kur më thirrën, gjoja se dymdhetë vjet u dënu, bile ua kom çu atë fotografinë, ai që u konë i caktum me më vra mue u dënu dymdhetë vjet...

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Po më interesojnë rrethanat e burgosjes të dytë të juj.

Sabri Novosella: Po. Burgosja e dytë, ndodhi kështu...

Anita Susuri: Cilin vit? Qat...

Sabri Novosella: Kjo më duket ka qenë '70-ën. U martu ni shok i joni i burgut Hyda Dobruna. Ka qenë anëtar i organizatës tonë, [bashkë] me shoktë e vet. U martue në Gjakovë. Na thirri neve shokve me marrë pjesë në darsëm. E në darsëm u propozue, bile këtu ky [Meriman Braha](#), ai ktu osht', këtu punon. Unë e di, ai e propozoi me dalë njëni, ishin nja 200 dasmorë e sa, me kërkni ni minut heshtje për Fazli Grajçevcin edhe në respekt të të burgosurve që i kishim nëpër burgje. E panë të arsyeshme, më propozunë mu, dola unë. I përshëndeta dasmorët, u bona përhapër dasmën edhe kërkova që të mbahet ni minut heshtje për Fazli Grajçevcin edhe në shenjë të respektit për shoktë që i kem nëpër burgje. U kry ajo punë edhe meniherë u hallakat puna. Atëherë më burgosën, më burgosën...

Anita Susuri: A ka folë dikush, ka tregu apo qysh?

Sabri Novosella: Ajo u bo botnisht para dasmës. Botnisht ajo u bo. Aty tani ke, ke, ke në darsëm Bardhyl Çausi. Ai Bardhyl Çausi ka qenë kryetar i gjyqit të Gjakovës. Erdh në gjyq, dëshmoi kundra meje m'i dhanë dy vjet burg. Edhe i majta ditë më ditë. Aty u burgosën edhe nja 30 vetë tjerë, u burgosën nga ni muj ditë.

Anita Susuri: Në cilin vend i keni majtë këto dy vite?

Sabri Novosella: Këto dy vite në Pejë i kom majt. Këto dy vite i kom majt, i kom majt në Pejë. Kta iu çova me dije tem {shikon në telefon}. Po osht' ni thanje shumë interesant...

Anita Susuri: Domethonë, pos Sabri Novosellës që gjatë hetimeve nuk përmendi asni emër dhe mori përgjegjësinë mbi vete për çka u dënua dhe 30 veta mbetën pa u burgosur.

Sabri Novosella: Po, se motra e Meriman Brahës u martu për Hyda Dobrunën.

Anita Susuri: Ju ka qenë hera e dytë kur jeni burgosë...

Sabri Novosella: Burgosja e dytë, po. Ai e boni darsmën, na thirrë tanë shokë po kishte thirrë edhe njerëz të njohur, të familjes të Gjakovës qaty. Mes tjerash e kish thirrë, e kish pa diqysh kah punon me ta, Bardhyl Çaushin. Ai Bardhyl Çaushi ishte kryetar i gjyqit komunal të Gjakovës. Ai faktikisht kishte deklarue edhe erdh në gjyq dëshmoi. U dënova dy vjet burg. E tash, atë çka që e ka thanë Meriman Braha, janë hetimet e ato të gjitha, të gjitha, unë nuk pranova askush.

Anita Susuri: A ka pasë dhunë sigurisht?

Sabri Novosella: Ë?

Anita Susuri: Me dhunë apo si?

Sabri Novosella: Po tash, ato të gjitha janë përjetue. Bile, beso në Zot as nuk du me folë për sene të tilla, se në kohën e shkaut m'u burgosë e mos me pasë tortura nuk ka ndodhë ajo punë. Nuk ka ndodhë ajo punë. Po njeri të gjallë nuk kam përmend. Mu m'i dhanë dy vjet burg të cilat i mbajta ditë më ditë. Kurse, 30 i burgosën tjerë, i majtën kah ni muj ditë.

Anita Susuri: E në burg, thatë ishit në burg në Pejë...

Sabri Novosella: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë Burgu i Pejës?

Sabri Novosella: Po, prapë Burgu i Pejës mundem me thanë ka qenë pak ma ndryshe se burgu i kohës së Rankoviqit. Në Burgun e Pejës tash nuk ishte Rankoviqi, ishte ni regjim pak ma ndryshe. Përndryshe ishte kryetari i gjyqit, bile erdh, Fuad Kryeziu. Unë edhe në libër e kam. Ka qenë arrogant e ka qenë ashtu... ndaj ne të burgosurve politikë ka pasë ni sjellje të jashtëzakonshme. Gja që edhe... qitash bile më thirri, se vllau i tij Ekrem Kryeziu, Resmie Kryeziu në bajë i kam. Kështu që edhe kam miqësi me ta. Po me Ekremin kom pasë edhe para se me ra në burg edhe gjatë... bile librin e parë, Resmia e ka shkru parathanjen, Ekrem Kryeziu e ka bo redaktimin, si rregull qysh osht'. Dy vjet burg, burg kalunë në burg. Në vetmi e tonat.

Anita Susuri: Dy vite keni qenë në vetmi?

Sabri Novosella: Jo, jo. Aty i kam majtë jashtë dy muj, kanë qenë nja nantë muj kam qenë në vetmi. Tani masanej erdh ky Mark Mërturi e me to krijum miqësi e i vazhdum lidhjet tona.

Anita Susuri: Si osht' me qenë në vetmi, gjatë gjithë kohës me qenë vet?

Sabri Novosella: Po provoje ni natë në shpi tane (qeshë). Hin në shpi mshele derën, vetëm 24 orë rri në dhomë tane. Jetë e vështirë, jetë e tmerrshme. Unë po thom të drejtën, atëherë kam qenë tjetër moshë, kam përjetu... veç tash me më ndodhë, tash me më ndodhë, jo që, faktikisht nuk e marrë ushqimin edhe marrë fund me jetë, s'jetoj ma. Vështirë osht'. Burgjet janë të vështira.

Anita Susuri: A keni pasë aty të drejtë për vizitë? A keni pasë të drejtë me dalë jashtë?

Sabri Novosella: Tash osht' rregull, burgu e ka pasë, më doket kah 15 minuta shëtitje ni oborr u konë shëtitje kah 15 minuta. Po vizita ka qenë, ni herë në mujtë, kom harrue. Ka qenë vizita.

Anita Susuri: A keni pasë të drejtë me marrë diçka që ju kanë sjellë?

Sabri Novosella: Po. Diçka na sillshin prej shpije. Po, qysh jo. Edhe këtu [Burgu në Prishtinë] motra Igballi osht' smu prej kamve t'u nejtë para dyrve të burgut t'u na pru. Na bishin diçka

Anita Susuri: A ka pasë diçka që për shembull që nuk osht' leju m'u marrë?

Sabri Novosella: Jo bre, pak diçka osht' lejue, s'u leju gjithçka. U konë e caktume. Kanë leju bukë me marrë, ndoni sallamë, ndoni diçka qashtu.

Anita Susuri: Libra për shembull?

Sabri Novosella: Ë?

Anita Susuri: Libra për shembull?

Sabri Novosella: Absolutisht në burgun e parë s'ka pasë. Vallahi edhe në Pejë s'na kanë dhanë. Në Pejë na kanë dhanë... e kem pasë ni të burgosun politik, ni katolik. E kish vra grunë edhe ni kojshi të vetin, ka dyshu nejse. E atij prej Italisë ia çojshin. Tash ish i dënumë për pushkatim, a po merr vesh. Atina i bishin libra tani i shfrytëzojsha, i lexojsha. Nuk na epshin libra. Kurse në Goliotok i kishim librat e bibliotekës edhe vishin, vishin.

Anita Susuri: E pas lirimimit prej burgut të dytë, qysh ka vazhdu pastaj jeta për juve? Sigurisht keni qenë gjithë i ndjekun.

Sabri Novosella: Kqyre, gjithmonë i ndjekun por kam punue. Tanë jetën kam punue. Kur jam ra në burg kam punue, kur kam dalë prej burgut meniherë e kam çelë dyqanin kom punue, rrobaqepësi. Jom shku në Turqi. Në Turqi e kom hapë dyqanin për shitjen e këpucve. Jom shku në Suedi meniherë

kom hi. Unë kom pasë princip jetësor të parën punë me siguru ekzistencën, mos me konë i varun prej dikujna. Atëherë në Turqi kur kemi kalu, e kemi themelu degën e organizatës të Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe Viseve të Tjera Shqiptare. E kemi qujtë Komiteti Hasan Prishtina. Aty tanë kohën sa kemi vepru, kena vepru të organizum. Të njejtën gja masi kem dalë në Suedi kam kalu. Edhe aty e kemi organizu meniherë degën e organizatës edhe ka vepru dega e organizatës. Faktikisht deri në çlirimin e Kosovës.

Anita Susuri: Ju ma herët e tregut që jeni detyru me u largu...

Sabri Novosella: Po.

Anita Susuri: Po paraprakisht çka keni bo? Prej daljes prej burgut të dytë domethonë ku ka qenë viti '72 ndoshta...

Sabri Novosella: '71.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu këto vite, çka ju ka detyru që ju m'u largu? Çka ka qenë ajo e fundit?

Sabri Novosella: Shif tash, na kemi qenë të organizum. U zbulu organizata. U zbulu organizata. Organizata u zbulu në vitin, në vitin 1979. U burgos Shefqet Jashari, u burgos Hysen Gërvalla, tentunë me burgosë edhe Jusuf Gërvallën edhe ai iku shkoi në Gjermani. Rrezikova unë m'u burgosë, kalova në Shqipni. Tani disa shokë mbetën apert pa u burgosë. Metush Krasniqin. Mbetën disa pa u burgosë.

Anita Susuri: E ju me çfarë dokumente keni dalë jashtë? A keni marrë të dikujt apo...

Sabri Novosella: Jo, në Shqipni jom dalë, kam kalu kufinin. Kam kalu kufinin. Me, tash, ju kallxon qysh e kem kalu kufinin te Tereza kur folni me to. Se Tereza na ka çu deri në kufi, vllau i saj edhe burri i saj Marku, Mark Mërturi. Ata më kanë qit' anej kufinit. Kufini jem, kalimi jem ka qenë...

Anita Susuri: A ka pasë ndonjë problem për me kalu kufinin?

Sabri Novosella: Po, faktikisht me rreziqe tepër të mëdha po kam kalu. Unë prej momentit, këtë burgu i tretë, unë jo prej trimërie a prej burrnje, po nuk kam pasë me ra në burg. Unë me vete e kom mbajttë revolen vazhdimisht edhe në atë rrugë. Prej shpisë, po disi bre kom pasë fat diqysh, nuk di diqysh, edhe fat po edhe njerëzit, më kanë ndihmu more njerëzit. Në burgosja e fundit, si zhvillohet situata. Ka qenë doktor Ramadan Xhema, vllai i tina osht' Xhim Xhema osht' një ndër bosat ma të mëdhej të Amerikës. Ka qenë doktor në spitalin e Prishtinës.

Shkojnë dy UDB-ash një mramje me bo një kontrollë. Njani me bo ni kontrollë mjekësore. Ky ia bon kontrollimet ato edhe hin mrapa perdës me u veshë. Po kishin qenë dy vetë. Njëni i thotë, "Ku po dalim

sonte?” Ata UDB-ashët. Ky i thotë, “S’munëm me dalë sonte. Na duhet me ra ma herët, se nesër në ora pesë kena me burgosë Sabri Novosellën”, ata vet me veti. Ky doktori nin, s’bon zo. Si e kryen punën prej atyhi, po u njifsha me to e kisha nifarë njohësie, erdh më njoftoi.

Të nesrit në mëngjes erdhën me më burgosë, veç unë isha përgatitë. E kisha çu shpinë... atëherë prej atyhit në Dumnicë të Llapit. Aty qëndrova tri ditë. Prej aty te Mark Mërturi e prej Mark Mërturit edhe tash të kallxon Tereza qysh u zhvillu ajo punë. Po revole kom pasë gjithmonë me veti. Për arsye se nuk kom pasë me ra në burg. Te tanë shoktë që ranë nëpër burgje, te tanë i shkatërrunë. Krejt i shkatërrunë. Kanë pasë pasoja tepër të rana.

Unë me ra në burg, kumeditë sa do të qëndroj unë. M’i qitë shoktë... e kisha Metush Krasniqin, kisha ni varg shoksh përjashta. Derisa e kom kalu kufinin, revolën e kom pasë me veti. Me pa që po burgosna, e kisha vra vetën. Ka qenë shumë ma lehtë. Masi dola në Shqipni kaloi veç ajo rruga që e përshkruva e e thashë.

Anita Susuri: E në Turqi qysh e keni, qysh e keni zhvillu kontaktin me familjen ktu? Se prej tregimit të zonjës Igballe e di që nuk kanë ditë familja se ku jeni?

Sabri Novosella: Katër muj.

Anita Susuri: Po. Edhe kur keni dërgu letrën e parë ka qenë si me kode, diçka që kishit ditë vetëm ju. Nëse mundeni për këtë?

Sabri Novosella: Katër muj, se ishte bre problem edhe puna e telefonave. Familja kish telefon, unë kisha harru numrin e telefonit. Dy muaj qëndrova në Shqipni, pastaj dy muaj qëndrova në Turqi, në Izmir. Derisa më i rregullun letrat. Si shkova atje, i pata njerëzit e mi meniherë. Meniherë i pata njerëzit e mi edhe kur zbritëm në Izmir, u nal ajo anija. Prej atyhit e kisha ni emër të njerëzve të mi atje që i kisha. Unë s’kisha qenë kurrë në Turqi, për herë të parë. T’u pytë, t’u pytë ni Leblebixhi han i thojshin ni vend ku ka qenë ata tregartë ata shoktë tonë, më çunë aty...

Anita Susuri: Po më intereson nëse mundeni edhe pak këtë pjesë me familjen? Letrat që i keni dërgu.

Sabri Novosella: Tash morëm lidhje me familje. Atëherë burri i Igballit erdh. Se burri i Igballit tetë herë ka ardhë për mue nëpër botë me më takue. Tani me ma pru grunë e fëminë e... se unë jetova dymdhetë vjet pa gru. Se shoqja ime... gjashtë vjet kesh në burg e dymdhetë vjet në...

Anita Susuri: Jashtë Kosovës.

Sabri Novosella: Jashtë. 18 vjet ka jetu pa mu. E tash u msu me jetu pa mu. Tash s'po jeton me mu (qeshë). Jetojna bashkë veç jo bashkë me mu kah do që shkoj unë. I thom kah do që të shkojmë shkojmë bashkë, rrijmë bashkë. Kem banjat, kem katunin, kem në Shqipni kem banesa, kem shpija.

Anita Susuri: E në Suedi qysh u bo që kalut anej?

Sabri Novosella: Atëherë në Suedi... u vranë shoktë. U vra Jusuf Gërvalla, u vra Bardhosh Gërvalla. Atëherë kërkunë këta shoktë, thanë, gjithqysh me kalu... se ish dega e organizatës, vepronte organizata atje. Atëherë unë i rregullova dokumentat atje në Suedi, në Turqi. Gruja nuk erdh, nuk dashti me ardhë me dalë me hupë fëminë. “Po kthehna në Prishtinë”, u kthy. Unë kalova në Zvicërr, prej Zvicrrës në Gjermani, prej Gjermanisë u vendosa në Suedi. Atje i mora letrat, se kisha dokumentat që jom konë në burg. Mas pesë muje i mora letrat. Posa i mora letrat meniherë e hapa ni dyqan edhe aktivitet edhe me konë i pavarur ekonomikisht. Gjithmonë e kom pasë kta princip të jetës.

Anita Susuri: A ishte në Turqi apo në Suedi që kishin dërgu dikond me ju vra? Ju thatë që shumë herë keni pasë...

Sabri Novosella: Po. Tash kështu. Turqi, tash jemi shokë me ta. I ka marrë katër banesa prej meje në Çerret të Kavajës, me Shukri Demirin. Ai në moshën dhetë vjeçare kish dalë në Turqi nga Kumanova me familje. E kishte kry shkollimin e kishte bo polic. Vjen ni njeri, i Kumanove dikund edhe thotë, “Po të pagujmë”, thotë, “me na ndihmu me pru Sabri Novosellën deri në kufinin e Greqisë”. Beso për veti, qysh në kufi të Greqisë me më çu. Ata kanë qenë të interesum me më kidnapue. Se kidnapimi atëherë e dishin që me më kidnapue osht', nuk ish puna veç me m'vra. Edhe më mysin edhe mbi t'gjitha me qit' shokë që i kom nëpër Kosovë. Ky vjen... edhe kto krejt në libër i kom. Vjen në dymdhetë të natës, 12:15 te unë vjen në Adapazar prej Stambollit dhe kështu, kështu, kështu tregon. Policia turke e burgosin atë. Vallahi, këta më patën thirrë edhe mu në pyetje e ni boshnjak ish konë polic. Ai, tha, “Nuk osht'”, tha, “veç ky, ka hala”. Ai vet i treti kish qenë. Njo i ikë, dy i burgosin. Dy i dënojnë kah katër vjet e gjysë në burg.

Anita Susuri: Kjo ka qenë për shkak aktivitetit që e keni vazhdu edhe jashtë?

Sabri Novosella: Jo, jo, s'ka lidhje edhe mrena edhe jashtë. Me vra Sabri Novosellën sikur armik. Po. Qysh kanë vra plot tjerë. E kanë vra Jusuf Gërvallën. Kur e vrapnë Jusuf Gërvallën, në qat' kohë deshtën me më vra edhe mue. Unë pshtova. Kanë vra, plot tjerë kanë vra. Kështu që, ai ka qenë rast në Turqi. Masanej kanë qenë disa herë në Suedi. Kanë qenë në Gjermani, që i mrami ka qenë ky, “Syri i Popullit”...

Anita Susuri: A janë dënu? Po menoj këta ma herët, a janë dënu?

Sabri Novosella: Vetëm këta dy në Turqi që janë dënu ka katër vjet e gjysë, kurse ky u dënu dymdhetë vjet burg. Ata tjetër... ishte bre edhe ni problem i madh tash. Për shembull, njerëzit që, njerëzit që më pshtojshin prej tyne ata kishin najfarë lidhjesh me ta. Atëherë, “Me besë na po të kallxojmë të kish kujdes qishtu po me qit’ nëpër gjyqje na s’munëm me ardhë”. Kështu që, këta janë burgosë. Dy të Turqisë edhe njo i ktuhit osht’ burgosë dhe janë dënue.

Anita Susuri: Ju më tregutë që prej dhjetorit të ‘79-ës jeni largu...

Sabri Novosella: Po.

Anita Susuri: Edhe jeni detyru faktikisht me shku...

Sabri Novosella: Me 23 dhetor kam qenë i detyrum m’u largu dhe kom arritë me kalu kufinin, jam hi në Shqipni.

Anita Susuri: Ndërsa pas luftës në vitin ‘99 jeni kthy.

Sabri Novosella: Po.

Anita Susuri: Po më intereson krejt aktiviteti juj jashtë, çka ka qenë ma konkretisht?

Sabri Novosella: Konkretisht, faktikisht ne kem formu degë të organizatës edhe kemi vepru në kuadër të organizatës.

Anita Susuri: Cilat kanë qenë shembull aktivitetet?

Sabri Novosella: Po edhe ato aktivitete tona kanë qenë në përgjithësi me propagandue çashtjen shqiptare. Me përgatitë njerëz për luftën e fundit.

Anita Susuri: A ka pasë edhe lidhje me kjo që “Tre Përqindshi”, qysh kanë qenë këto, këto...

Sabri Novosella: Kanë qenë të gjitha ato. Unë kam qenë kategorisht kundër “Tre Përqindshit”. Me tre përqindsh shlirohet Kosova tre përqind. Për Kosovë duhet me dhanë të gjitha. Po ka qenë, për shembull, ai aksioni, “Familja ndihmon familjen”, po. 200 euro me ia çu familjeve. Unë ia kom çu dy familjeve. Për çdo muj 400 euro i kom çu. Kom ndihmu, vazhdimisht i kom ndihmu njerëzit edhe ekonomikisht se kisha mundësi. Punojsha, kom ndihmu njerëz që kanë qenë në nevojë.

Anita Susuri: E familja nuk osht’ bashku me juve...

Sabri Novosella: Dymdhetë vjet. Mas dymdhetë vjete ka ardhë ajo te une kemi vazhdu jetën bashkë.

Anita Susuri: Kjo ka qenë para luftës po më duket?

Sabri Novosella: Në Turqi ka ardhë gruja ka nejt me mu tri vjet. Prej Turqisë u kthy në Kosovë. E prej Turqisë unë kom kalue në Suedi. Atje kom jetu vet. Në Turqi kom jetu ni vjet e gjysë vetëm, pastaj më ka ardhë tri vjet gruja. Masi kom kalu atje në Suedi, tani kom jetu, krejt kam jetu dymdhetë vjet. Me ktu e me atje dymdhetë vjet kam jetu vetëm. Masanej më ka ardhë gruja, fmija, familja. Tash ni vajzë më ka mbetë atje në Suedi se i kam kthy krejt në Kosovë. Ni vajzë më ka mbetë atje. I ka dy djem.

Anita Susuri: Qysh kanë ndiku te ju këto ngjarjet në Kosovë që janë? Për shembull prej '89-ës kanë fillu edhe ato grevat e minatorëve, demonstratat e ndryshme që janë bo.

Sabri Novosella: E tash për grevat e minatorëve, demonstratat të gjitha ato, tragjike për neve kanë qenë demonstratat e '81-tit. Të cilat i ka organizu Serbia edhe banda kriminale e Enver Hoxhës. Jom autor i atyne ngjarjeve. Kurse këto tjerat kanë qenë zhvillim normal. Ka qenë zhvillim normal. P'e marrim qat' rastin e minatorëve. Kur minatorët u dha lajmi, p'e ngojmë në televizion tha, "Hinën minatorët në dhe", a po merr vesh. E majtëm ni tubim aty në Suedi, me çu nja 300-400 vetë.

Do, unë ju thom patriotat të pasulit, "M'u tubu na për çdo mramje me bisedu", e kështu. U çova edhe jom nervoz nga natyra, ashpër i sulmova, "Çka do të vijmë aty me hangër darkë a?" Edhe në mënyrë protestuese dola prej sallës. Mas meje ngajtën qiky Rasim Haradina që p'e shihni në burg, që osht' kah dënohet atje. Rasim Haradina, Xhabir Zharku edhe ai ka qenë në burg edhe nja pesë-gjashtë shokë. Kanë dalë mas meje.

Veç ni fjalë më kanë thanë, "Çka po thu baci Sabri?" "Unë po thom", gjoja që kisha dugojen me pesë-gjashtë punëtor me krejt. I mshela krejt. Thashë, "Ata në dhe, na në grevë urie. Ata në grevë urie, na në grevë urie". "Me ty jem baca Sabri". Jemi kthy jemi ulë kambëkryq në tokë. Aty 27 vetë u bonëm. Nesër 75 vetë u bonëm. Edhe e disha mirë, bile dy kanë qenë edhe intelektualë, nuk i lejsha me hi hiç në grevë urie. Se ata e disha, Kadri Osmani edhe Ismail Rugova m'u marrë me mjete informimit. Se edhe e dishin suedishtën shumë mirë. Thashë, "Ju keni punë boll". Se meniherë e disha që Suedia e interesume.

Ma tepër u folë e u bo zhurmë nëpër televizione nëpër krejt greva jonë që po solidarizohemi me, me minatorët, a po merr vesh. Tash ni natë, faktikisht në të dytën natë na hinëm në grevë urie. Kena nejt në grevë urie. Masi janë dalë minatorët prej dheut, ni natë ma vonë na jena dalë. Nantë ditë a dhetë ditë sa e majtën ata?

Anita Susuri: Tetë.

Sabri Novosella: Ë?

Anita Susuri: Tetë.

Sabri Novosella: Tetë ditë, qaq. Ni natë na ma shumë atje e kena vazhdue grevën e urisë jena solidarizu me ta. Çdo gja që ka ndodhë, çdo gja që osht' bo jena solidarizue kena nga. Protesta, demonstrata në tona antë e Europës. Në Amerikë kena bo, a po merr vesh? Për çdo ngjarje kena bo protesta, kena bo demonstrata. Bile tash, se kjo fryma e enveristave, sot janë të tillë të pashërueshëm. Edhe kjo osht' interesant, po ju kallxoj. Ishim, u organizue ni demonstratë në Stockholm. Stockholmi e Malmo e kishim 700 kilometra, po shkum prej tona anëve. Unë apet ai rrobaqepësi, i mora flamujt iu hoqa yllin krejtve komplet, ju hoqa yllin. Kur shkum aty, kur i qitën flamujt, pa yll. Ni pjesë *auu* {onomotope}, ni pjesë ikën *auu* {onomotope}. Qysh kështu, a po merr vesh? U kthym në Malmo.

Mrena dy dite erdh Profesor Doktor Fehmi Agani. Po u vendoste Profesor Doktor Muhamet Shatri. Osht' ende ai, ni aktivist edhe shok i joni. Tash unë të nesrit isha shku në mëngjes në shpi të tina e masanej me u nisë për tubime. Aty ishim në, mëngjesin na kish bo ajo gruja e tij. Po bisedojmë. T'u bisedu erdhën dy stalino-enverista, sikur sot që i kemi. Ni Ragip Reçica me njo tjetër. Po Regipi ma i vjetër ma, goxha dost. U ulëm aty si u përshëndetëm iu drejtue ai tjetri, Profesor Fehmi Aganit. "Profesor", tha, "a bon kështu?" Tha, "Qysh?" "Sabri Novosella ia ka hjekë yllin flamurit pesë rremësh". "Po pse s'ia keni hjekë ju? T'ia kishit hjekë ju, nuk ia kish hjekë Sabria" (qeshë). Metën. Ma ylli në flamurin kombëtar shqiptarë në krejt Europën e në botë nuk u pa ma, prej qatij rasti. Faktikisht unë ia hoqa, Profesor Agani e vërtetoi. Ma s'e qiti kush, as s'u përmend kush.

Anita Susuri: Po më intereson edhe kto vitet '98-'99, lufta. Domethonë, keni qenë jashtë po qysh e keni përjetu ju?

Sabri Novosella: Shif, shif tash. Në atë kohë kam qenë shumë kam qenë në Shqipni. Se në vitin 1992, Sali Berisha, tash edhe ku më njofti, se kur ra regjimi komunist në Shqipni erdh Sali Berisha në pushtet edhe u ndrrunë ambasadorët. Erdh ni ambasador i Shqipnisë në Stockholm për me pa. Çka me pa, zibidi ish ardhë prej Shqipnisë. Me ato tesha të vjetrumë, me ato këpuce, besharet. Mas do viteve e mbajtëm ni tubim edhe e thirrëm. Erdh ambasadori.

Edhe i thashë djalit, se e kisha llirin, punojsha në 13 butike. Shkoi e veshi, e mathi, e ndreqi. Ai i tregon Sali Berishës që qishtu, "Sabri Novosella u sillë mirë me mu", e kështu. Ai ma bon ftesën për 28 nëntor të vitit 1992 më thirrë mu thotë, me letër thirrë thotë, "Merre kond dush e hajdeni se shënohet 28 nëntori", po ishte përvjetor, ishte niqind vjetori a qysh ishte. Unë me aeroplan shkum aty, prej atyhit në Vlorë. U kry ceremonia. Nejta dhetë ditë në Shqipni edhe e pashë Shqipninë. Ish bo Shqipnia, qysh e kisha lanë mos vet. Po dashnia ndaj atëdheut shumë e madhe.

Kështu që, unë vitin e ardhshëm '93-ten... kisha punu atje, kisha bo pare. Kisha dyqane me pesë-gjashtë punëtorë punojsha. Bisha punëtorë prej Polonie... edhe unë po thom në '92-shin, në

'93-shin kur e kom lonë në punë asni shqiptarë në krejt Suedinë ma mirë ekonomikisht nuk ka qëndrue. Tani kanë bo. I kisha dy punëtori. Morra pare shkova në Shqipni. Bleva truell në Tiranë. Në Tiranën e Re, Selitën e vogël, unë kom maru villën e parë tre katëshe. Sot osht'. Në Durrës, mora troja edhe atje fillova punë. Meniherë fillova ndërtimin, gjo që edhe sot jom ka punoj, s'e kom lonë kurrë.

Ndërkohë, unë e lash punën në Suedi edhe tash u ensha, shkojsha-visha. Po me punu punojsha në Shqipni. Kur e mora trollin e parë në Tiranën e Re, Selitën e vogël erdhën do kojshi aty, ata venali. Thanë, "Nga je?" Thashë, "Jam nga Prishtina, e po jetoj në Suedi". "A nga Suedia ke ardhë në Shqipni? Po si nga Suedia? Po Shqipëria osht' hale". Unë s'e disha çka osht' haleja. Ni [Xun Çetta](#) më merrke me makinë. Ai këtu tash me cinizëm, tha, "Ktu hale i thojnë qenefit". "Po, po", tha, "Shqipëria osht' qenef". Thashë, "Nëse Shqipnia osht' qenef, unë jam në krye të këtij qenefi. Po du në qenef tem me jetue". Parajsën e Suedisë e lashë, shkova aty. Po qashtu, kem punu atëherë, kem punu e kem bo ashtu.

Po e tash puna e luftës. Në vitin 1998, 120 kosovarë i kom pasë në shpijat e mija. I pata maru shpijat ma. Në vitin 1999 i kom pasë 114 kosovarë. Por krahu jonë ka qenë krahu i Ahmet Krasniqit, se Ahmet Krasniqi ka qenë i organizum qysh '75-ën prej Metush Krasniqit. Na e kemi çu për ushtar. Faktikisht ai ka qenë ni djalë i mrekullueshëm edhe i familjes të Aziz Zhilivodës e tjera, e tjera. Atëherë Ahmeti edhe emrin të njoftun, personalitet. Ishte kolonel, jo ia kanë ngjitë emrin gjeneral, po ka qenë, ka qenë oficeri ma i shkollum në krejt ish-Jugosllavinë. E pati fat u vendos atje në Kroaci, me kroat atje. Edhe u zgjodh ministër i ky, Bujar Bukoshi, e emëroi ministër të ushtrisë. Atë me kusht e [pranon]. E propozon për ministër të ushtrisë. Thotë, "Nëse e zgjedhni Sabri Novosellën ministër të punëve të brendshme, Shefqet Jasharin këshilltar timin, unë pranoj. Përndryshe unë nuk do të pranoj kurrë". Po pavarësisht nga të gjitha tani kta kanë qenë vazhdimisht kontakt me...

Bile edhe ni shpi e kom pasë, ni shpi dy katëshe, mjaft e madhe. Ata ia dorëzova Ahmet Krasniqit, se Ahmet Krasniqi tash shtabin e kishte në Tiranë. Pra bazën e organizimit e kishte në shpinë time. Atë shpi unë ia fala. Thashë, "Sa duhet të duhet, kur s'duhet muni me shitë edhe ato pare për luftë". Faktikisht, në Kosovë janë bo dy lufta. Ni luftë e kanë bo krahu jonë. Se ky Rifat Jashari, bile e ki aty e çova me fotografi aty. Në banjë të mija patën vet ata doktortë e mi, "A e ke njoftë", thotë, "drejtorin përpara?" Tha, "Po në '81-tën", unë shkojsha merrsha materiale në Stamboll. Te unë ka qenë Shaban Jashari, Hamëz Jashari, Rifat Jashari. Rifat Jashari gjallë osht', a po merr vesh.

Faktikisht grupin e parë me ushtrinë na e kena organizue. Grupin e dytë na e kena organizue, me kah 30 vetë. Grupin e dytë na e kena organizue. Bile grupin e parë kur e çumë, Ymer Berisha ngajke i kryjke këto punë me Shaban Mulollin. Kishim shokë njerëz që i kryshin këto punë. Financimin e ka bo Bujar Bukoshi. More, thojnë çka thojnë, unë s'di kush osht' e çka osht'. Financimin e grupeve që i kena çu me i ushtru në Shqipni edhe kushtojshin. Se ishin kah 30 vetë u dufke me çu me kasarne [kazerm], me ushtrim, me oficerë që ushtroshin. Se nuk dojshim me kapë njerëzit me i çu n'luftë me thanë, kape qit' pushkë e dil qaty. Me punu njeri, me kanë të pregaditun.

Atëherë, bile kur u kthynë s'pari ky Ymer Berisha osht' e tha, kur u kthynë tash po më raporton mu. Thashë, “Çka botë, si botë?” Tha, “Bac, i çumë i ndreqëm, i rregullum i vendosëm”, tha, “edhe kollodantin”, tha, “edhe fërçën e dhomëve ju kom ble tonëve veç e veç. Mos u bo merak që i kena lanë diçka keq”. Çdo gja shkoi mirë, çdo gja shkoi në rregull. Tani, lufta jonë ish me ia hapë rrugën Amerikës, NATO-s. Lufta e Hashimave, e LPK-së, se unë kom shkru libër. Kom libër të veçantë, bile qaty e çova {bën me shenjë nga telefoni}. Puqi i LPK-së në Lëvizjen Demokrate Vizionare të Metush Krasniqi. Pse? Ata i udhëheqte, ata i udhëheqte bandat e Enver Hoxhës.

Klosi, disa Klose janë aty. Bedri Islami. Njerëz të Sigurimeve të Enver Hoxhës. Para sa dite e pashë vet me vesh e ndëgjova, me sy e pashë Klosi e akuzoi, e mbrojke Rusinë, e akuzojke Europën p'e... po o vllau jem, se kombi shqiptarë kanë qenë, o motrat e mija, gjithmonë kanë qenë dy linja. Linja kombëtare anti-sllavo-ortodokse dhe linja kombëtare, linja anti-kombëtare, linja kombëtare. Linja anti-sllavo-greko-ortodokëse. Gjatë historisë sot jemi aty. Sot të gjithë ata shqiptarë që nuk janë me Amerikën nuk janë me NATO-në, janë me Rusinë, janë me Serbinë. Me serbo-rusët pansllavizmi. Kështu ka qenë që nga Beteja e Savrës⁴, se i kom në libra këto, i kom argumentu deri sot s'më ka kundërvu kërkush. Kto janë të vërteta.

Edhe sot ti për shembull, unë me kta, trimat e kto p'e çujnë Shoqata e ish të Burgosurve Politikë, kjo osht' rren. Kjo osht' Shoqata e ish të Burgosurve Stalinisto-enveristë. Qe kqyrë ti, a ka dikund naj flamur amerikan, a ka diçka amerikane, a ka diçka... apsolutisht. Pse? Se këta janë anti-euro-amerikanë. Këta anti-euro-amerikanët janë deshte s'deshte pro-ruso, pro-ruso-serbo, e vërteta kështu. Unë vllavit tem i thom qashtu. Para ca nete u bona kërrsh me to. Merre me mend, unë kom thanë, merrni librat e juve, shkruni. I kanë shkru 40 libra për Adem Demaçin, vetëm ni fjalë a e ka shkru kundër Stalinit, kundër Enver Hoxhës. Kurrë!

Me iu pre ktyne Enver Hoxhën... kom thonë lexoni librat e Jakup Krasniqit, Hydajet Hysenit, Selatin Novosellës, këtij ia radhiti. Krejt libra që kanë shkru, a e kanë vetëm ni fjalë kundër Stalinit apo Enver Hoxhës, kurrë. Shqipnia, unë e du Shqipninë. Jo. Unë e du Sabrinë. Unë pse e du Sabrinë e du familjen teme, e du kombin tem. E due atë superfuqi botërore që ma siguron mbijetesën, që ma siguron ekzistencën. Dy libra i kom shkru për At Fishtën. Thotë At Fishta, pse osht' njëri prej gjenive ma të mdhej që ka kombi shqiptar. Thotë, “Jo ne si popull i vogël, po asni popull i vogël nuk ka mujt me bo shtet ose me mbijetu pa e pasë ni shtet të fuqishëm që e ka mbrojtë”, dhe e jep formulën, “kombi shqiptar me ekzistue i duhet ni shtet i fortë, i fuqishëm, i qytetnum që e ka interesin e vet me na mbrojtë e me na mbajtë në kambë. Përndryshe, s'kem ekzistencë”.

Ishim ni nejt rreth 30 vetë, ni mramje meniherë mas luftës. Hydajet Hyseni ish ulë këtu, qe qitu unë ktu {tregon rreth odës së Shoqatës të ish të Burgosurve Politikë}. Mbajti fjalimin e gatë sikurse këta fjalimet

⁴ Beteja e Savrës (fusha e Savrës, në Shqipëri, Myzeqeja e sotme) u bënë luftime më 18 shtator 1385 midis Osmanëve dhe një ushtrie shqiptare, shumë më të vogël. Osmanët dolën fitimtarë dhe pjesa më e madhe e serbëve dhe të princave shqiptarë u bënë vasalë.

i kanë të gata. Ai Fidel Castro tetë orë folke, majke fjalim. Edhe e përfundoi. Tha, “Kom frikë që ky faktor ndërkombëtar s’ka ardhë për interesa tona, ka ardhë për interesat e veta”. Meniherë mora fjalën, “Unë kom frikë që ky faktor ndërkombëtar ka ardhë për interesa tona, s’ka ardhë për interesat e veta. Se nëse s’ka ardhë për interesat e veta, ka ardhë për interesa tona. Kur t’na sheh çfarë budallë jena, çfarë lopë jena shkon. Për dy orë vjen Vuçiqi na fshin nga faqja e dheut”. Po ku munëm na me ekzistitu pa Amerikën, ku munem na me ekzistitu pa NATO-n? Po këto janë çmendurina.

Se vet, beso Zot, para sa dite pata rast, p’e shoh ni emision televiziv në televizion të Shqipnisë, s’e di cili ke. Ishin disa akademikë edhe disa doktorë shkencash. Ky doktori i shkencash tha, “Historia e shqiptarëve duhet m’u rishkrue”. Akademiku iu përgjegj, “Jo”, tha, “m’u rishkrue. Historia e shqiptarëve duhet m’u shkru nga fillimi. Se fillim e mbarim osht’ e falcifikume osht’ në frymën e lindjes pro-sllavo-greko-ortodokse”. Akuzohet Kongresi i Berlinit, akuzohet Konferenca e Londrës, akuzohet Konferenca e Varshavës. Janë çmend bre, janë çmend Albinat kundër vendimave, kundër Rambujesë. Po këta nuk janë normal. Këta normal nuk janë! Çka boni Kongresi i Berlinit? Mos të hij në historina se me të vërtetë... i kom folë nëpër libra edhe emisione, p’e ngarkojmë tepër.

Anita Susuri: Unë kurgjo, veç deshta me ju dëgju edhe qysh e keni gjetë Kosovën pas luftës. Se thatë që në luftë me gjithë ato ndihma që i keni bo te familjet. Jeni kthy në dhjetor, thatë në ‘99-ten në Kosovë. Qysh e gjetët?

Sabri Novosella: A në nandor? Me ushtrinë amerikane jom kthye. Nesra kom takim me Ambasadën e Amerikës vijnë aty në banjë se m’kanë shpallë agjent i Amerikës. More, unë ishalla jom po unë nuk di qysh osht’ agjenti, se unë Amerikën e du ma shumë se Sabrinë. Se për Amerikën s’kom familje, s’kom Sabri. Nesër në ora 11:00, si me juve e pata sot në 11:00, nesër në ora 11:00, bile m’duhet me shku drejt atje se më vijnë kta të ambasadës.

Tash kështu, osht’, unë kom jetu në Suedi edhe jetoj në Suedi. Suedija osht’ shtet qe 600 vjet. Ata çdo gja e shohin nga puna, puna. Tash unë si jom ardhë meniherë e kom çelë firmën. Kom fillu ndërtimet. Kom fillu ndërtimet në Prishtinë, 36 ndërtesa i kom bo. Në shtatë qytete të Kosovës ndërtesat e para unë i kom bo. Prishtinë, Fushë Kosovë, Mitrovicë, në Malishevë, në Ferizaj, Gjilan edhe në Kllokot. Tani në Kllokot i kom bo, i kom pesë ndërtesa, 66 mijë metra katror objekte i kom të ndërtume aty. Pse?

Tash, tona këto pallavra që mirren e mbajnë fjalime. More zotni, leni pallavrat kthenu punës. Se çka? Me zhvillu bujqësinë, me zhvillu blegtorinë, me zhvillu industrinë e cila përpunon prodhime bujqësore e të blegtorisë. Me zhvillue minierë. Me zhvillue vendin në çdo aspekt, në çdo drejtim. Kjo osht’ fitore jona. Se Amerika na ka hjekë shkaun prej Kosove, Amerika na mbron prej shkau. Përndryshe, të gjitha pallvrat tjera janë pallavra. Unë sot, për shembull, veprimet, ato që i kom thanë për Albin Kurtin, ai po i realizon, po i sheh.

Ai po i kundërvihet Amerikës, “Amerika do gypa, Amerika do gypa. Amelika, Amelika”. Po a je normal more ti? A i ki mend në kry, a ku? Kujna po i thu ti ashtu? Amerika osht’ shpëtim i jonë, se pa to fshihemi nga faqja e dheut. Asnjo nuk ekzistojmë. Ka thanë i madhi Konica, tri libra ni profesor i Tiranës i ka shkruar, “Sabri Maxhuni Novosella ni Konicë e kohës tonë”, dhe i thashë, “Profesor”, s’e kisha pa kurrë po kishin se ish burgosë edhe të Shqipnisë i marrë krejt pa pagesë. Ora Butka profesor doktor ia kish çu librat e mija. Ai kumeditë. Tash, “A shkon ky emri jem me Faik Konica”, tha, “Unë e kom shkru, përgjegjësi e imja është”. Mirë, në rregull.

Ai e shkrun, tash, këtë Faik Konicën. Çka thotë Konica, thotë, “Zoti na krijoi, rastësitë na shpëtun, politikajt na shkatërrun”. Kjo osht’. Fati jonë ka qenë. Sa herë na u ka dhanë kushti me kriju shtet sllavo-grekët-ortodoksët kanë bo çmos me futë njerëzit e vet me na, mos me na lonë me bo shtet. U bo shteti. Ato shtete gjithmonë me përkrahjen e faktorëve ndërkombëtar na kanë ndihmu. U bo shteti, i kanë hi me shkatërru shtetin. Nuk kanë mujtë me shkatërru shtetin. Tani çka? Sa herë janë formu udhëheqësia e shtetit i kanë hy me i futë njerëzit e vet. Gjithmonë i kanë futë, sot i kanë. Si në Tiranë, si në Prishtinë, për fatin tonë të keq. Kjo osht’ fatkeqësi e jona.

Anita Susuri: Zoti Sabri, faleminderit shumë për intervistën edhe kohën!

Sabri Novosella: Faleminderit edhe prej jush. Më besoni ndryshe e kom paramendu. A din që kom qenë shumë në dilemë a me ardhë, a mos me ardhë?! Thashë, hajt janë do farë qiso që me hupë do kohë. Po ju pashë që jeni me të vërtetë shumë serioze në punë e ju dëshiroj sukses, ju dëshiroj punë të mbarë. Vetëm njerëzit e palodhur që s’u lodhtë me mu prej fillimit deri tash, këta çojnë popullin e çojnë kombin përpara.